



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



RAPORTI I KRYETARIT TË KOMUNËS
PËR PUNËN E ORGANEVE TË KOMUNËS
GJATË VITIT 2008

Janar 2009, Prishtinë

Përmbajtja

I.	REALIZIMI I OBJEKTIVAVE PROGRAMORE	4
II.	MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS, EKZEKUTIVIT DHE TRUPAVE PUNUESE	7
III.	KRYETARI I KOMUNËS	8
1.	Kabineti	8
2.	Zyrat	11
a.	Zyra ligjore	11
b.	Zyra për integrime evropiane	11
c.	Zyra për auditim të brendshëm	13
d.	Zyra për marrëdhënie me publikun	13
e.	Zyra e avokaturës publike	14
f.	Zyra për çështje gjinore dhe mundësi të barabarta	15
g.	Zyra për teknologji informatike	15
h.	Zyra për kthim	16
i.	Zyra për komunitete	17
j.	Departamenti i prokurimit	17
IV.	REALIZIMIT I BUXHETIT	19
1.	Shpenzimet buxhetore	19
2.	Të hyrat buxhetore	20
3.	Të hyrat vetanake të realizuara në vitin 2008	20
V.	AKTIVITETI I DREJTORIVE SIPAS FUSHAVE	22
1.	DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT	22
a.	Spektori i Punëve të Përgjithshme dhe Juridike	22
b.	Spektori për shërbime profesionale të Kuvendit dhe të Ekzekutivit	23
c.	Spektori teknik	24
d.	Spektori i bashkësive lokale	24
e.	Spektori i gjendjes civile	25
f.	Njësia monitoruese - Zyra pritëse	26
2.	DREJTORIA E EKONOMISË, FINANCAVE DHE ZHVILLIMIT	27
a.	Spektori i buxhetit	27
b.	Spektori i ekonomisë	28
c.	Spektori i inspektionit	28
d.	Spektori i tatimit në pronë	29
e.	Zyra e shpërndarjes	30
f.	Spektori për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	30
3.	DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRËS DHE MBROJTJES SË MJEDISIT	32
b.	Spektori i Urbanizmit	32
c.	Spektori i Kadastrit dhe Gjeodezisë	35
d.	Spektori i Inspektionit të Ndërtimit	35
e.	Spektori i Mbrojtjes së Mjedisit	36
f.	Çështje tjera	36
4.	DREJTORIA E SHËRBIMET PUBLIKE DHE EMERGJENCËS CIVILE	37
a.	Spektori i Shërbimeve Publike	37
b.	Spektori i inspektionit komunal dhe komunikacionit	39
c.	Spektori i Emergjencës Civile	40
d.	Koordinimi i punëve me ndërmarrjet publike komunal	41
e.	Angazhimet shtesë të DSHP dhe EC	42
f.	Rrethanat kufizuese	42
5.	DREJTORIA E ARSIMIT DHE KULTURËS	43
a.	Statistikat e arsimit	43
b.	Ngritja e infrastrukturës shkollore, kulturo-sportive dhe furnizimet	44
c.	Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor	45
d.	Rezultatet e nxënësve në mësim	46
e.	Shërbimi i punëve të përgjithshme administrative	46
f.	Spektori i Kulturës dhe Gjinisë	47
g.	Spektori i Sportit dhe Rinisë	48
6.	DREJTORIA PËR INFRASTRUKTURË LOKALE	48
a.	Projektet e realizuara të infrastrukturës rrugore	49

b.	Hartimi i detyrave projektuese dhe identifikimi i nevojave	51
c.	Shqyrtimi i kërkesave	52
d.	Hartimi i paramasave dhe paralogarive	52
e.	Rrugët e përcjella në vitin 2009 për shkak të pengesave të ndryshme	53
7.	DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE	54
a.	Kujdesi parësor shëndetësor	55
b.	Enti i ndihmës së shpejti	55
c.	Inspeksioni i sanitarisë dhe shërbimi i veterinarisë	56
d.	Mirëqenia sociale	56
e.	Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore	57
f.	Investimet kapitale	57
g.	Buxheti dhe shpenzimet	58
8.	DREJTORIA E PRONËS	58
VI.	SHTOJCË ME TË DHËNA	60
	Shtojca 1. Pasqyra e realizimit të buxhetit për vitin 2008	61
	Shtojca 2: Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake në vitin 2007 dhe në vitin 2008	67
	Shtojca 3: Të dhënat për aktivitetet e Kryetarit të Komunës për periudhën janar-dhjetor 2008	68

Ky raport i Kryetarit të Komunës paraqet aktivitetet e organeve komunale gjatë vitit 2008. Raporti është përgatitur për Kuvendin Komunal në përputhje me nenin 59 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01/nr.110-445 të datës 31.03.2008, dhe me nenin 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040 (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/2008).

I. REALIZIMI I OBJEKTIVAVE PROGRAMORE

Kryetari i Komunës me Programin Zgjedhor është përcaktuar për realizimin e këtyre prioriteteve:

A. Prioritetet afatshkurta

- Ndalja e ndërtimeve pa leje;
- Hapja e rrugëve unazore dhe zhvillimi i brendshëm i rrugëve;
- Zbatimi i planeve rregulluese dhe lehtësimi i kushteve dhe procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit;
- Përmirësimi i nivelit dhe cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

B. Prioritetet afatgjata

- Kombinimi i zhvillimit ekonomik dhe urban;
- Zhvillimi harmonik ekonomik dhe hapësinor;
- Regjenerimi i ambientit, rritja e hapësirave të lira publike, sidomos e sipërfaqeve të gjelbëruara, objekteve dhe hapësirave rekreative dhe objekteve tjera për të rinj, fëmijë dhe të moshuar;
- Zgjidhja afatgjate e problemit të ujit për Prishtinën dhe rrethinën;
- Ndërtimi i Prishtinës së Re.

Në realizimin e prioriteteve afatshkurtra, gjatë vitit 2008 është punuar në këto drejtime:

- 1) Është riorganizuar inspekcioni i ndërtimit dhe ai komunal. Kjo ka mundësuar që të sigurohet kontrolli mbi ndërtimet, sidomos në brendi të qytetit dhe i ndërtimeve të objekteve kolektive. Për të rritur informimin dhe kontrollin mbi gjendjen e ndërtimeve, janë angazhuar edhe operatorë privat.
- 2) Në Kuvend është proceduar dhe është miratuar vendimi për t'iu qasë hartimit të 5 planeve rregulluese. Ka filluar ndërtimi i Unazës Qendër, e cila do të përfundojë në vjeshtë të vitit 2009. Po ashtu, po punohet në projektet e ndërtimit të unazës së brendshme, një fazë e së cilës do të fillojë në vitin 2009. Me financim të Qeverisë së Republikës së Kosovës janë zgjeruar hyrjet e rrugëve në Prishtinë nga Shkupi dhe Peja dhe po punohet në zgjerimin e rrugës nga Mitrovica. Në zgjerimin e hyrjes nga Podujeva dhe nga Llukari do të investoj komuna në vitin 2009. Ka filluar faza e parë e rregullimit të Sheshit të Pavarësisë Ibrahim Rugova. Në vitin 2009 do të përfundojë ndërtimi i këtij sheshi dhe do të projektohet me konkurs ndërkombëtar rregullimi i qendrës së Qytetit. Është shpallur tenderi për projektet ideore për sheshin Zahir Pajaziti dhe Sheshin Adem Jashari.
- 3) Janë ulur tarifat në ndërtim dhe janë siguruar mundësitë e kompensimit me tarifa komunale të tokës e cila merret për ndërtime për nevoja publike. Janë lehtësuar procedura e marrjes së lejeve të ndërtimit dhe është shtuar dukshëm numri i lejeve të lëshuara.

- 4) Në vitin 2008 kanë qenë në ndërtim afër 100 rrugë të qytetit dhe pjesëve rurale. Fillimi i ndërtimit të rrugëve në viset e thella rurale, siç është ajo deri në Hajkobillë dhe Glllogovicë, rruga për Viti të Marevcit dhe Ballaban. Ndërtimi i shkollave të reja në fshatra në afat të gjatë do të ndikojë në zhvillimin harmonik hapësinor të Komunës.
- 5) Së bashku me MAPL është përgatitur Ligji për Prishtinën, i cili nga muaji shtator i vitit 2008 pret procedurat në Qeveri. Me këtë Ligj sigurohet status i veçantë i Prishtinës në organizimin dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarë, bëhet organizimi nënkomunal i shërbimeve për qytetarë dhe parashihen burime suplementare të financimit të investimeve në Kryeqytet. Janë zhvilluar përgatitjet për decentralizimin e shërbimeve të dokumentacionit personal në 5 qendra të Prishtinës, të cilat pritet të jenë operacionale në deri në muajin mars 2009. Gjatë muajve të verës është punuar me kohë të zgjatur me palë, sidomos te certifikatat e lindjes. Po punohet në implementimin e E-administrimit. Nga buxheti i Komunës dhe në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe MAPL janë siguruar fondet për përfundimin e ndërtesës së re të Komunës, e cila pritet të hapet në muajin prill të vitit 2009 duke krijuar kushte shumë më të mira për punë dhe për rritjen e efikasitetit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Për realizmin e prioritetëve afatgjata janë ndërmarrë këto aktivitete:

- 1) Është përfunduar ‘Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal’, janë ulur normat e tatimit në pronë të cilat fillojnë së zbatuari nga muaji janar i vitit 2009 dhe janë bërë përgatitjet për uljen edhe të tarifave të tjera. Në krahasim me vitin 2007, të hyrat vetjake të komunës janë rritur për 46% dhe pritet që deri në fund të vitit 2009 të dyfishohen. Po punohet intenzivisht në sigurimin dhe shfrytëzimin e burimeve jashtëbuxhetore për financimin e investimeve. Janë bërë përgatitjet për fillimin e hartimit të planit rregullues për Zonën Ekonomike të Prishtinës.
- 2) Ka filluar organizimi për qeverisjen korporatave të ndërmarrjeve publike komunale. Janë themeluar komisionet e aksionarëve të këtyre ndërmarrjeve dhe janë shpallur konkurset për anëtarë të bordeve. Në bashkëpunim me Komisionin Evropian është themeluar Agjencioni Regjional për Zhvillim, i cili mbulon komunën e Prishtinës, Podujevës, Obiliqit, Fushë Kosovës, Lipjanit dhe Drenasit. Ky agjencion do të angazhohet në sigurimin e fondeve dhe implementimin e projekteve për zhvillim të qëndrueshëm regjional.
- 3) Në kuadër të politikave zhvillimore vend qendror i është dhënë ngritjes së cilësisë së arsimit dhe të shëndetësisë. Në vitin 2008 është punuar në ndërtimin e 12 shkollave (9 fillore dhe të mesme të ulta dhe 3 të mesme të larta), nga të cilat janë inauguruar 6 shkolla (Mat, Llukar, Glllogovic, Mramuer, Dabixhevc, Vranidoll). Në ndërtimin e shkollave është siguruar një bashkëpunim i ngushtë me MASHT. Me USAID është nënshkruar protokollin për ndërtimin e përbashkët të një shkolle fillore dhe për zgjerimin e 4 shkollave tjera. Me këtë dinamikë të ndërtimit, pritet që deri në fund të vitit 2010 të tejkalohet plotësisht problemi i ndërrimit të tretë dhe të katërt. Është inauguruar një Objekt i QMF-së dhe ka filluar ndërtimi i katër QMF-ve të reja dhe 48 banesave sociale mbi bazën e koncesionit. Është punuar në identifikimin e hapësirës për ndërtimin e Spitalit të Qytetit.

- 4) Janë zhvilluar konsulta profesionale me ekspertë të planifikimit hapësinor dhe me Agjencinë Kosovare të Pronave për fillimin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe të Planit Zhvillimor Urban në vitin 2009.
- 5) Është përmirësuar mirëmbajtja e hapësirave të gjelbruara dhe janë zgjeruar sipërfaqet e gjelbëruara me mbi 10%. Gërmia, parku i qytetit dhe sipërfaqet e gjelbëruara në vitin 2008 ka qenë më të pastra dhe më të mirëmbajtura se më parë. Është krijuar hapësira e gjelbër në sheshin Ibrahim Rugova dhe te Rrethi (rreth një hektar). Së bashku me MAPL dhe Komisionin Evropian janë përgatitë programet për rregullimin e tre parqeve dhe të një objekti sportiv: Parkut të Gërmisë, Parkut të Qytetit, Parkut në Qendrën Universitare dhe një stadioni të tenisit në oborrin e shkollës “Ismail Qemali”. Këto projekte do të realizohen në pranverë të vitit 2009. Do të vazhdohet me rregullimin e hapësirave të gjelbra në Dardani dhe në Ulpianë, të objekteve sportive në Sheshin e Pajtit dhe të objekteve tjera sportive me koncesion.
- 6) Ujësjiellësi “Prishtina” ka bërë përgatitjet për regjenerimin e rrjetit kryesor të ujësjiellësit në qytet. Në vitin 2009 do të punohet në magjistralen kryesore dhe në pastrimin e kolektorit të lumit Prishtina. Në vitet në vijim do të vazhdohet me rrjetën sekondare. Është propozuar për financim nga Konferenca e Donatorëve ndërtimi i Fabrikës së Re të Ujit në fshatin Shkabaj. Në vitin 2008 është përfunduar profili urban për Prishtinën e Re dhe mbi këtë bazë në vitin 2009 do të hartohen planet rregulluese. Po punohet në identifikimin e burimeve të financimit për ndërtimin e kompleksit të infrastrukturës në këtë pjesë të qytetit, para se të fillohet me lëshimin e lejeve të ndërtimit.

Rrethanat kufizuese në realizimin e objektivave afatgjata dhe afatshkurta gjatë kësaj periudhe, e të cilat mund të kenë efekte edhe në të ardhshmen janë:

- 1) Kapaciteti i ulët buxhetor i komunës në krahasim me gjendjen e infrastrukturës rrugore, shkollë, shëndetësore, të objekteve sportive dhe të kulturës në qytet dhe karshi migrimin dhe presionit të madh social në Kryeqytet;
- 2) Prolongimi, pa arsye reale, i miratimit të Ligjit për Prishtinën që është i paraparë me Kushtetutën e Kosovës dhe me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, i cili Prishtinës do t'i sigurojë një status çfarë e kanë edhe kryeqytetet e vendeve të tjera – pjesëmarrje në buxhet në harmoni me funksionet e Prishtinës si Kryeqytet dhe organizim më funksional;
- 3) Mungesa e Ligjit mbi trajtimin e objekteve të ndërtuara pa leje nuk mundëson legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje;
- 4) Vonesat në nxjerrjen e Ligjit mbi partneritetin publik-privat dhe koncesionin, të Ligjit mbi hyrjen borxh të komunës dhe të atij për shitjen e pronave komunale, pamundësojnë marrëveshjet eventuale me partner të brendshëm dhe të jashtëm për investime mbi baza të partneritetit dhe për sigurimin e burimeve jashtëbuxhetore për financim;
- 5) Kufizimet e vëna nga Korniza Afatmesme Buxhetore për punësim të ri janë pengesë serioze për freskimin e stafit me njerëz të ri, që zotërojnë aftësi të teknologjisë informatike dhe kanë mundësi më të mëdha për të përballuar fluksin e madh të kërkesave që shtrohen para organeve të Komunës. Komuna në afat të shkurtër dhe të gjatë ka nevojë për staf të ri për punë në sporte, specialistë nga fusha e arkitekturës dhe shkencave të tjera teknike, juristë të pronës dhe gjeodet të diplomuar.

II. MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS, EKZEKUTIVIT DHE TRUPAVE PUNUESE

Gjatë vitit 2008 janë mbajtur 13 mbledhje të Kuvendit të Komunës, prej të cilave 12 mbledhje të rregullta dhe një mbledhje e jashtëzakonshme. Kuvendi gjatë kësaj periudhe ka miratuar: Statutin, 3 (tre) rregullore dhe 108 vendime të ndryshme.

Përgatitjes së këtyre mbledhjeve iu ka parapri puna e komiteteve të Kuvendit si dhe e Drejtorive, përkatësisht e Këshillit të Drejtorëve.

Komitetet kanë mbajtur mbledhje si vijon:

- mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa 9 (nëntë) krahasuar me 7 mbledhje të mbajtura në vitin 2007
- mbledhje të Komitetit për Komunitete 17 (shtatëmbëdhjetë)
- mbledhje të Komitetit për Ndërmjetësim 1 (një)
- mbledhje të Komitetit për Urbanizëm, Kadastër dhe Ambient 7 (shtatë)
- mbledhje të Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Strehim 19 (nëntëmbëdhjetë)
- mbledhje të Komitetit për Arsim dhe Kulturë 9 (nëntë)
- mbledhje të Komitetit për Zhvillim Ekonomik 17 (shtatëmbëdhjetë)
- mbledhje të Komitetit për Shërbime Publike 14 (katërmëdhjetë)
- mbledhje të Komitetit për Pronë 14 (katërmëdhjetë)

Këshilli i Drejtorëve ka mbajtur 17 mbledhje (krahasuar me 20 mbledhje të mbajtura në vitin 2007). E veçanta e punës së Këshillit të Drejtorëve gjatë vitit 2008 është aplikimi i punës ekipore në trajtimin e problemeve ndërdisiplinore që ka rezultuar me efikasitet dukshëm më të lartë në kryerjen e detyrave të tyre.

Gjatë vitit 2008 janë mbajtur 2 mbledhje të Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive dhe 4 mbledhje të Grupit Komunal për Kthim. Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim ka mbajtur një takim.

Përgatitjet dhe përcjelljet teknike të këtyre takime i ka bërë sektori për Shërbime profesionale të Kuvendit dhe të Ekzekutivit të Komunës.

III. KRYETARI I KOMUNËS

1. Kabineti

Aktivitetet e Kryetarit të Komunës sa i përket qeverisjes së Komunës së Prishtinës nga data 3 janar 2008 deri me 31 dhjetor 2008 janë paraqitur sipas sektorëve. Puna dhe aktivitetet e kryetarit janë të ndërlidhura ngushtë me të gjitha fushat. Në këtë pjesë të raportit janë paraqitur aktivitetet e Kryetarit të Komunës, kabinetit të tij dhe zyrave të ndërlidhur drejtpërsëdrejti me të, ndërsa në vazhdim raportohen rezultatet e arritura në fusha të ndryshme, të cilat operativisht mbulohet nga drejtoritë përkatëse. Të dhënat që mbështesin këto aktivitete janë paraqitur në shtojcën 3 të këtij raporti.

a. Qeverisja komunale dhe bashkëpunimi ndërinstytucional:

- Me qëllim të koordinimit të punës dhe rritjes së efikasitetit të institucioneve komunale dhe arritjes së objektivave janë mbajtur 127 aktivitete me zyrtarë komunal,
- Vizita në terren për inspektimin e punimeve infrastrukturore 54,
- Takime, koordinim dhe udhëheqje të grupeve punuese, këshillit të drejtorëve, mbledhje te asamblesë, mbledhje të komitetit për politikë dhe financa në takime formale dhe jo formale, janë mbajtur 122,
- Takime konsultative individuale me drejtorët për çështje specifike të drejtorive, janë mbajtur 197 takime,
- Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucione, organizata, ndërmarrje publike dhe administrate publike, lokale, rajonale dhe qendrore, janë mbajtur 81 aktivitete,
- Takime dhe koordinim me përfaqësues të partive politike të nivelit lokal dhe qendror, janë mbajtur 51,
- Takim me institucionet qendrore 128,
- Takime dhe aktivitete jashtë zyrës së kryetarit me qëllim të përfaqësimit të interesit të komunës janë mbajtur 65,
- Kryetari ka marre pjesë në ceremoni zyrtare vendore si dhe të prezencës ndërkombëtare, ceremoni festive dhe raste përkujtimore në 199 raste.

b. Transparenca komunikimi dhe përfshirja e qytetarëve në qeverisje:

Ky objektiv programor është realizuar nëpërmjet aktiviteteve, politikave dhe masave të mëposhtme:

- Pjesëmarrje në konferenca dhe seminare me qëllim të prezantimit të punës dhe të realiteteve të komunës në 87 raste
- Me qëllim të identifikimit të nevojave dhe të kërkesave të qytetarëve si dhe të përfshirjes së tyre në qeverisjen e Prishtinës janë mbajtur 138 takime individuale dhe grupe
- Takime, prezantime publike si dhe debate publike janë mbajtur në 74 raste
- Me qëllim të rritjes së transparencës dhe të qasjes sa më të madhe të medias në punën e kryetarit janë mbajtur 28 aktivitete me gazetar (konferenca, takime formale dhe jo formale)
- Me qëllim të identifikimit të mundësive për lehtësimin e punës së gazetarëve janë mbajtur 12 takime individuale me drejtues të medias,
- Shoqëria civile si partner në qeverisje është konsultuar dhe angazhuar nëpërmjet pjesëmarrjes në komisione komunale si dhe në 49 takime në formën e konsultimit direkt
- Përfaqësues të sindikatave janë konsultuar në takime formale të paktën 6 herë

- Komuniteti fetar ka qenë i përfshirë në takime dhe konsultime për të trajtuar mundësitë e bashkëpunimit dhe të zgjidhjes së problemeve me të cilat ata përballohen, janë takuar dhe konsultuar në 23 raste.

c. Tubime me qytetarë

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 17 (shtatëmbëdhjetë) tubime me qytetarë për çështje të përgjithshme dhe ato specifike. Janë mbajtur edhe takime të tjera në të cilat janë shqyrtuar çështjet e statutit, buxhetit etj. Në këtë tubime dhe debate janë trajtuar tema të ndryshme si:

- Debat i rregullt me qytetarë më datë 29.05.2008 (1)
- Debate për ndryshimin e Statutit të Komunës (4)
- Debate për planet rregulluese (5)
- Debate për hartimin e Kornizës afatmesme të shpenzimeve buxhetore (1)
- Debate për hartimin e Strategjisë për Zhvillimin e Prishtinës (1)
- Debat - Java e Kuvendit (tetor 2008) (1)
- Debat me Publik me Ekspertët e Ekonomisë, shtator 2008 (1)
- Debat për planifikimin e buxhetit për vitin 2009 (1)
- Debat me qytetar dhe ekspert të planifikimit urban (1).

Përveç këtyre takimeve, Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me OJQ “ATRC” në shtator dhe tetor të vitit 2008 ka mbajtur 36 debate me qytetarë në Bashkësi Lokale. Temë e këtyre debateve ka qenë “Hartimi i buxhetit të Komunës me pjesëmarrje të qytetarëve”.

Në të gjitha debatet, numri i qytetarëve dhe i palëve të interesit ka qenë i kënaqshëm dhe ndikimi i qytetarëve nga këto debate ka qenë evident. Si rezultat, këto debate kanë ndihmuar udhëheqjen e Komunës dhe propozimet, idetë dhe sugjerimet e dala nga debatet janë marrë seriozisht.

d. Siguria publike

Siguria publike është trajtuar me kujdes të veçantë dhe janë arritur suksese të mira sidomos me rastin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës ku ceremonitë e shpalljes dhe të manifestimit qendror janë mbajtur në Prishtinë. Kryetari ka qenë i përfshirë në rreth 77 aktivitete, koordinime dhe konsultime me organet e sigurisë. Është siguruar koordinim shumë i mirë me organet e sigurisë për rrënimin e ndërtimeve pa leje.

e. Zhvillimi Ekonomik

Si prioritet i rëndësishëm në qeverisjen e Prishtinës, aktivitetet që lidhen me zhvillimin ekonomik kanë konsistuar në:

- Angazhimi në hartimin e strategjisë afatmesme zhvillimore, e cila është aprovuar në Kuvendin Komunal dhe po shërben si bazë për identifikimin e projekteve zhvillimore për Komunën dhe në bashkëpunim me donatorë,
- Është themeluar ‘Forumi për zhvillim i Prishtinës’ dhe janë mbajtur me palët e interesit si: biznese, shoqëri civile, banka, shoqata të bizneseve, donatorë etj., të cilët me idetë dhe angazhimin e tyre po e ndihmojnë komunën në identifikim e nevojave më prioritare,
- Bashkëpunimi me institucione financiare vendore dhe ndërkombëtare për të promovuar zhvillimin ekonomik, janë mbajtur 16 takime
- Takime dhe aktivitete të rëndësishme me investitor ndërkombëtar për zhvillimin ekonomik janë mbajtur në 48 raste,
- Biznesi lokal është konsultuar dhe angazhuar në aktivitete zhvillimore në mbi 64 raste.

f. Bashkëpunimi ndërkombëtar është realizuar në këto forma:

- Me fillimin e mandatit, me qëllim të urimit për marrjen e pozitës së kryetarit dhe për koordinimin e punës për shpalljen e pavarësisë së Kosovës, dhe pastaj për ndarjen e lokacioneve për ambasadat në kryeqytetin e shtetit të ri dhe për deklarimin e përkrahjes për Prishtinën, dhe në periudhën e fundit të vitit 2008 me qëllim të avancimit të bashkëpunimit dhe të promovimit të zhvillimit dhe të investimeve janë mbajtur rreth 96 takime dhe aktivitet me përfaqësues të ambasadave.
- Takime me përfaqësues të UNMIK, OSBE, BE, BB, FMN, CPI, Komision Evropian etj. janë mbajtur në 66 raste
- Udhëtime zyrtare jashtë vendit janë realizuar në 13 raste.

g. Rastet e pranuar në zyrën e kryetarit:

- Zyra e kryetarit ka pranuar rreth 1,131 raste, të gjitha rastet janë dërguar te organet kompetente për procedim adekuat.

h. Kabineti i këshilltarëve të Kryetarit

Kabineti i Kryetarit i përbërë nga 4 këshilltarë (me financim nga burime jashtë Komunës) ka qenë i përfshirë në shumicën e aktiviteteve të kryetarit si dhe ka pasur detyra specifike:

- Finalizimi i ‘Strategjisë afatmesme zhvillimore e Prishtinës 2008-2011’ që është aprovuar në Kuvendin Komunal, organizimi i takimit me 14 agjencione të OKB-së që veprojnë në Kosovë për të identifikuar projektet ku këto agjenci mund të kontribuojnë. Si dhe është bërë themelimi dhe mbajtja e 3 takimeve të forumit ekonomik të Prishtinës.
- Përgatitja e 9 projekt koncepte të cilat janë dorëzuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për financim nga IPA (Instrumenti Para-Hyrës i Bashkimit Evropian).
- Përgatitja e 35 projekt koncepte për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për tu prezantuar në Konferencën e Donatorëve dhe për përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve.
- Fillimisht në mungesë të zyrtarit përkatës dhe të kufizimeve për të punësuar staf të ri në komunë, njëri nga Këshilltarët e Kryetarit ka menaxhuar me aktivitetet e zyrës për Integritet Evropian. Puna e tij ka konsistuar në koordinimin e të gjitha aktiviteteve komunale që kanë të bëjnë me çështjet e integriteteve evropiane. Janë organizuar shumë aktivitete për nder të Ditës së Evropës më 9 maj, janë trajtuar një numër i zyrtarëve komunal për çështje të integriteteve evropiane, pjesëmarrje në takimet e organizuara nga MAPL dhe institucionet tjera në lidhje me integritet evropian etj. Dhe si përfundim është themeluar dhe funksionalizuar zyra për integritet evropian
- Konsultimi direkt me kryetarin dhe stafin komunal në çështje specifike
- Pjesëmarrja në hartimin e Ligjit për Prishtinën
- Riorganizimi i brendshëm i komunës
- Hartimi i raporteve
- Marrëdhëniet me publikun dhe rritja e transparencës së qeverisjes
- Trajtimi i rregulloreve të brendshme
- Trajtimi i rregulloreve për çështje të planifikimit urban
- Trajtimi i programeve zhvillimore
- Këshilla në hartimin, trajtimin dhe zbatimin e planeve urbane etj.
- Hartimi i analizës së përshkrimit, harmonizimit dhe sistematizimit të vendeve të punës. Nisja e procedurës për hartimin e rregulloreve për përshkrimin, harmonizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës
- Organizimi i zonave administrative të qytetit të Prishtinës,

- Themelimi i bordit këshillues të ekspertëve për çështje urbane,
- Aktivitetet lidhur me themelimin e Agjencisë Rajonale të Zhvillimit në bashkëpunim me Komisionin Evropian.

2. Zyrat

a. Zyra ligjore

Aktivitetet të Zyrës Ligjore gjatë vitit 2008 kanë qenë të lidhura, fillimisht me përgatitjen dhe harmonizimin e Statutit të Komunës me Rregulloren 2007/30 dhe rregulloreve të tjera përkatëse dhe pas shpalljes së pavarësisë harmonizimi i akteve të Komunës me Kushtetutën dhe aktet ligjore të Republikës së Kosovës përfshirë përgatitjet për harmonizimin e statutit me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale.

Në kontinuitet zyra ka punuar në:

- dhënien e këshillave dhe informacioneve për ekzekutivin, sektorët/zyrat, institucionet e arsimit dhe të shëndetësisë dhe ndërmarrjet publike komunale;
- shqyrtimin e të gjitha propozim-vendimeve dhe rregulloreve, të cilat i janë dërguar zyrës nga ana e drejtorëve të drejtorive, të drejtorëve të institucioneve arsimore, shëndetësore dhe të ndërmarrjeve publike lokale;
- zbatimin e Rregullores për Vetëqeverisje Lokale 2007/30 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 2000/45 për qeversijen lokale të komunave të Kosovës;
- hartimin e Statutit të Komunës së Prishtinës, të Rregullores së punës së Kuvendit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteteve, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dhënien e banesave në shfrytëzim me qira dhe akte të tjera të lidhura me kompetencën e Komunës,
- pjesëmarrjen aktive në: Këshillin e Drejtorëve; Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës,
- pjesëmarrje në grupe punuese për: hartimin e raportit të punës për vitin 2007, hartimin e Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, hartimin e Statutit të Komunës në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale 03/L-04,
- pjesëmarrje në takime të ndryshme në Shqipëri, Maqedoni dhe në komunat tjera të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me nivelin komunal,
- përpilimin e kontratave për shfrytëzim të tokës-objekteve, në pajtim me vendimet e miratuara në Kuvendin e Komunës;
- këshillime, komente, hartimin e vendimeve, publikimin e konkursit për anëtarë të Bordit të drejtorëve dhe ndihmë tjetër në aplikim të dispozitave të Ligjit për ndërmarrjet publike lokale për Kuvend, ekzekutiv, drejtorët e ndërmarrjeve dhe për Komisionin Komunal të Aksionarëve;
- pjesëmarrje në grupet e caktuara për miratim të: Rregullores për përdorimin e gjuhëve, Rregullores për tatimin në pronë dhe Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale;
- pjesëmarrje në takimet e kolegjiut të zyrtarëve ligjorë të komunave të Kosovës.

b. Zyra për integrime evropiane

Si zyrë e re e krijuar në vitin 2008, Zyra për Integrim Evropian koordinon të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me procesin e integrimeve evropiane në kuadër të komunës. Zyra bashkëpunon me Agjencinë për Integrim Evropian (AIE) në Kryeministri dhe Zyrën për Integrim Evropian (ZIE) në kuadër të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal

(MAPL) në koordinimin e aktiviteteve në lidhje me proceset të Integritimit Evropian (IE). Po ashtu koordinon detyrat e Komunës së Prishtinës që burojnë nga Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE). Zyra mbikëqyr aktivitetet e drejtorive dhe zyrave në Komunën e Prishtinës që burojnë nga PVPE si dhe dokumentet tjera strategjike të MAPL dhe Qeverisë së Kosovës. Sipas kërkesës së MAPL dhe AIE, përgatit raporte të rregullta për qëllime të monitorimit të aktiviteteve lidhur me PVPE dhe mbikëqyrë zhvillimin e rregulloreve në komunë për të siguruar që ato janë në përputhje me standardet evropiane etj.

Këto aktivitete në vitin 2008, Zyra i ka realizuar si vijon:

- (i) Janë organizuar takime të rregullta nga Kolegjiumi i Zyrarëve Komunal për Integritime Evropiane, në mbështetje nga EYG (organizatë joqeveritare) dhe Agjensioni për Integritime Evropiane në kuadër të MAPL-së. Takimet janë mbajtur nëpër të qytetet të ndryshme të Kosovës (Gjakovë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan, Prishtinë etj.). Në këto takime janë diskutuar problemet e ndryshme që lidhen me implementimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE). Nga gjithsej rreth 1,590 aktivitete që dalin nga PVPE, për komuna janë specifikuar rreth 150 aktivitete që bien direkt në linjë të përgjegjesisë së komunave.
- (ii) Në muajin tetor 2008 kemi marr pjesë në takimin e kolegjiut të zyrarëve për integritime evropiane në Ohër për të diskutuar implementimi e PVPE.
- (iii) Gjatë periudhës 20-22 mars 2008 dhe 14 maj 2008, ZIE ka koordinuar trajnimin për politikën e Bashkësisë Evropiane të 6 zyrarëve komunal të mbajtur nga ekspertët e Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).
- (iv) Më datë 17 Prill 2008, ZIE ka organizuar një takim në komunë me zyrarët për Integritime Evropiane të të gjitha komunave të Kosovës dhe me zyrarë nga MAPL ku është diskutuar drafti i Planit për Partneritet Evropian (PVP) i përgatitur nga Qeveria e Kosovës. Në këtë takim janë diskutuar dhe është arritur pajtimi për aktivitetet që do të organizojnë komunat në lidhje me shënimin e Ditës së Evropës, më 9 maj.
- (v) Më datë 15 Prill 2008, ZIE ka marrë pjesë në takimin e kolegjiut të zyrarëve të komunave të Kosovës për integritime evropiane ku janë zgjedhur organet drejtuese të këtij kolegjiut. Zyrtari i Integritime Evropiane i Komunës së Prishtinës është zgjedhur anëtar i kryesisë të këtij kolegjiut.
- (vi) ZIE në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, Kulturës dhe Sportit ka organizuar aktivitetet për shënimin e Ditës së Evropës më datë 9 maj 2008. Janë organizuar këto aktivitete: (i) të gjitha shkollat e Prishtinës kanë organizuar një orë mësimi për ditën e Evropës, (ii) është organizuar një debat me nxënës lidhur me Integritimet Evropiane, (iii) janë vendosur shenjat e BE-së nëpër rrugët e qytetit, (iv) në bashkëpunim me shkollat janë organizuar koncerte, (v) është organizuar maratona në vrapim (me fanella të BE-së).
- (vii) Gjatë muajit qershor 2008, ZIE ka marrë pjesë aktive në përgatitjen dhe diskutimin e draftit të rregullores së punës së Kolegjiumit të zyrarëve komunal për integritime evropiane.
- (viii) Gjatë muajit shtator 2008, është mbajtur një takim pune në kuadër të komitetit për komunitete për të diskutuar çështjet e integritimeve evropiane dhe rolin e komuniteteve me qëllim të sensibilizimit të komuniteteve jo shumicë për implementimin e aktiviteteve që dalin nga PVPE.
- (ix) Për aktivitetet komunale që dalin nga PVPE, zyrtari komunal për integritime evropiane ka raportuar në baza tre mujore në MAPL.

c. Zyra për auditim të brendshëm

Gjatë vitit 2008, është themeluar Zyra e auditimit të brendshëm në komunë, në përbërje prej 3 zyrtarëve të auditimit, prej të cilëve njëri ka punuar edhe më parë si auditor i brendshëm në Komunë. Me këtë janë krijuar kushtet për punë shumë më intensive në auditivin e brendshëm.

Krahas kësaj, në fillim të vitit 2008 është formuar *Komiteti i auditimit të brendshëm*, siç parashihet me Ligjin për Auditim të Brendshëm. Ky komitet ka këto detyra: (i) aprovon planin e punës të Zyrës së auditimit dhe (ii) mbikëqyrë implementimin e rekomandimeve që nxjerrë auditori i brendshëm në raportet e auditimit. Komiteti i auditimit ka mbajtur mbledhje të rregullta për të shqyrtuar të gjitha raportet e auditimit të brendshëm të përgatitura nga Zyra e auditimit të brendshëm. Puna e zyrës së auditimit të brendshëm në Komunën e Prishtinës gjatë vitit 2008 është bazuar në planin e aprovuar nga ky Komitet.

Në përputhje me detyrimet që dalin nga Ligji i Auditimit të Brendshëm dhe bazuar në standardet e auditimit, si dhe në bashkëpunim me Komitetin e auditimit të brendshëm, Zyra e auditimit të brendshëm ka përgatitur: (i) planin e auditimit për vitin 2008, (ii) planin strategjik 2009-2011 dhe (iii) planin vjetor 2009. Këto plane janë aprovuar nga Komiteti i auditimit dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Gjatë vitit 2008, zyra e auditimit të brendshëm ka finalizuar këto raporte audituese:

- (i) Menaxhimi i të hyrave vetanake në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale: auditimi është bërë për periudhën prej 01/01/2006 deri më 31/12/2006,
- (ii) Procedurat e rekrutimit në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme - njësia e personelit: auditimi është bërë për periudhën prej 01/01/2005 deri më 31/12/2007,
- (iii) Buxheti për minoritete në zyrën në Graçanicë: auditimi është bërë për periudhën prej 01/01/2007 deri më 31/12/2007. Në këtë auditim kanë marrë pjesë pesë auditor nga pesë komuna të Kosovës si dhe një këshilltar ndërkombëtarë. Ky auditim është bazuar në pilot auditimin e organizuar nga projekti i BE-së 'Përkrahja e mëtutjeshme e kontrollit të brendshëm të financave publike dhe auditimit të brendshëm' që menaxhohet nga AER-i. Udhëheqës i ekipit të auditimit ka qenë auditori i brendshëm i Komunës së Prishtinës.
- (iv) Procedurat e prokurimit në Komunën e Prishtinës: janë audituar procedurat e prokurimit për periudhën janar-shtator 2008. Në auditim kanë marrë pjesë tre auditor te komunës.

d. Zyra për marrëdhënie me publikun

Zyra për Marrëdhënie me Publikun (ZMP) ka punuar në përputhje me parimet, të cilat sigurojnë transparencë dhe komunikim me opinionin:

- Informimi i drejtë dhe me kohë i qytetarëve për punën dhe aktivitetet e komunës,
- Ngritja e imazhit dhe besueshmërisë së komunës në raport me qytetarët,
- Zbatimi i planit të veprimit për transparencë,
- Përgatitja dhe botimi i fletushkave për informim të qytetarëve,
- Organizimi i seminareve për gazetarë që mbulojnë punën e Komunës së Prishtinës,
- Organizim i tryezave dhe debateve për tema të ndryshme që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale.

ZMP gjatë viti 2008 ka bërë një aktivitet të dendur të punëve sipas përgjegjësive dhe rolit që ka. Kjo zyrë çdo dië është kontaktuar dhe ka kontaktur mediat e shkruara dhe elektronike që veprojnë në Prishtinës si dhe ka raportuar rregullisht për punët dhe aktivitetet e Komunës së Prishtinës. ZMP ka përcjell të gjitha takimet protokollare të Kryetarit të Komunës, mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të Këshillit të Drejtorëve dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa. Përmes komunikatave për media është informuar opinioni publik për të gjitha këto takime.

ZMP ka distribuuar për media numër të madh informatash, lajme, ftesa, komunikata, reagime dhe kumtesa për opinion, të cilat janë plasuar edhe në ueb-faqen e Komunës së Prishtinës dhe në intranet. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar 20 konferenca për medie, të cilat janë përcjell nga pothuajse të gjitha mediat elektronike dhe të shkruara. Po ashtu, ZMP në bashkëpunim me OJQ “ATRC” ka organizuar debatet publike me grupe të interesit për Statutin e ri të Komunës.

ZMP ka zhvilluar edhe kampanjën për debatet publike me qytetarë, si dhe ka organizuar debate me qytetarë me temë: Planifikimi me pjesëmarrje- hartimi i buxhetit komunal me pjesëmarrje me qytetarë”. Në bashkëpunim me ATRC-në është botuar broshurë me propozimet e qytetarëve për projekte të ndryshme sipas lagjeve.

Është bërë akreditimi i gazetarëve që mbulojnë aktivitetin e komunës së Prishtinës. ZPMP ka bashkëpunuar me Asociacionin e komunave, OJQ-të, KFOR-in, OSBE-në, dhe institucionet tjera vendore. Është përcjellur vazhdimisht shtypi ditor dhe mediat elektronike, duke veçuar informatat mbi Komunën e Prishtinës, të cilat kjo Zyre i ka ruajtur dhe arkivuar. Së bashku me Kabinetin e Kryetarit është punuar në funksionalizimin më të mirë të ueb-faqes Komunës, e cila pritet të aktivizohet në fillim të vitit 2009 me format dhe përmbajtje të re.

ZKM ka përkrahur mediat e shkruara dhe elektronike në mbulimin e aktiviteteve të komunës. Komunës së Prishtinës i është rezervuar hapësirë e kënaqshme në tri televizionet nacionale dhe në të gjitha gazetat ditore. Janë mbuluar nga mediat përgjithësisht të gjitha aktivitetet e Kryetarit dhe të drejtorive si dhe seancat e Kuvendit.

e. Zyra e avokaturës publike

Funksioni dhe kompetencat e kësaj zyre janë të rregulluara dhe të përcaktuara me ‘Ligjin mbi Avokaturën Publike’. Gjatë viti 2008, kjo Zyre ka bërë përfaqësimin juridik të Komunës në institucionet gjyqësore dhe në institucionet tjera me qëllim të mbrojtjes së interesit juridik dhe pasuror të komunës, në vitin 2008 ka procesuar 285 lëndë, prej të cilave 164 kanë qenë të reja dhe 121 kanë qenë të bartura nga viti paraprak. Zyra e Avokaturës Publike ka marrë pjesë në 609 seanca gjyqësore dhe ka pranuar: 53 Aktgjykime kundër të cilave janë parashtruar 19 Ankesa, 5 Revizione, 75 Aktvendime, 6 Propozime për Ekzekutim, 11 Konteste Administrative, 3 Parashtrësia dhe 17 Njoftime.

Nga Zyra e Avokaturës Publike janë përgatitur në afatin e paraparë ligjor: 24 Ankesa kundër Vendimeve gjyqësore (Aktgjykimeve) të shkallës së parë, 8 Revizione kundër vendimeve gjyqësore (Aktgjykimeve) të shkallës së dytë, 5 Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 9 Kundërshtime, 6 Padi, 2 Kundërpadi, 5 Kallëzime Penale, 64 Përgjigje në Padi, 13 Parashtrësia, 25 Njoftime, 38 Kërkesa për Shënime.

Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk ka pasur ndonjë kontest të humbur përveç disa marrëveshje gjyqësore për kompensimin e tri pagave pas daljes në pension dhe marrëveshjes

gjyqësore që kemi arritur me një person. Ndër kontestet nga të cilat parashihet mundësia e fitimit të kompensimit real të tokave deri më tani janë vetëm dy, të cilat gjinden në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ndër kontestet më të rënda, të cilat kanë qenë në procedurë në vitin 2008 dhe vazhdojnë të të jenë edhe në vitin 2009 janë dy: me kompaninë “Gollaku” dhe me Fabrikën e Amortizatorëve.

f. Zyra për çështje gjinore dhe mundësi të barabarta

Gjatë vitit 2008, zyra për çështje gjinore dhe mundësi të barabarta ka zhvilluar këto aktivitete::

- Organizimi i tryezës me temë ‘Roli i amvisërive në kursimin e ujit dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit urban’
- Organizimi i diskutimeve me persona me nevoja të veçanta,
- Me rastin e Muajit të punësimit të personave me aftësi të kufizuara është organizuar punëtori me 10 persona me aftësi të kufizuara,
- Është shënuar 25 Nëntori si ‘Dita ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj gruas’ me qëllim të ngritjes së vetëdijes për parandalimin e dhunës në familje,
- Zyra ka organizuar disa seminare dhe trajnime si: seminari në fushën e të drejtave të njeriut organizuar bashkë me MAPL, trajnimi mbi mbrojtjen e fëmijëve nga punët e rënda organizuar bashkë me ILO-në, trajnimi për parandalimin e dhunës në familje të organizuar bashkë me OSBE-në, trajnime për strategjinë e zhvillimit rural, seminari për studime gjinore, tryeza ‘Roli i femrës në pozita vendimmarrëse’, debate me gratë në fushën e shëndetësisë etj.
- ‘Qendra informative për Gratë’ ka qenë e hapur për te gjitha gratë e komuniteteve për këshillime dhe udhëzime,
- Bashkëpunimi me OJQ nga zonat rurale në kuadër të projektit ‘Qendre Informative për Gratë’ ku janë mbajtur tryeza me OJQ të grave, takime me gra nga viset rurale etj.
- Nga muaji prill është formuar edhe Njësia për të drejtat e njeriut (NJDNJ), është caktuar koordinatori, kanë filluar trajnimet dhe është punuar në planin e punës,
- Zyra ka marrë pjesë në hartimin e programit të Kosovës për Barazi Gjinore, ka mbajtur takime me Ministrinë e Pushtetit Lokal, ka mbajtur mbledhje të rregullta mujore me qendrën rajonale të punësimit, kurse për gratë minoritare janë organizuar takime për t’i informuar për të drejtat dhe për institucionet të cilave mund t’u drejtohen për ndihmë, etj.

g. Zyra për teknologji informatike

Zyra për teknologji informative (TI) ka udhëhequr dhe kontrolluar punën e sistemit të teknologjisë informative me qëllim të zbatimit të standardeve dhe ofrimit të shërbimeve sa me cilësore dhe shpërndarjes së informimit mbi teknologjinë informative. Në veçanti, kjo zyrë:

- (i) ka zbatuar politikat e harduerit/softuerit kompjuterik dhe të qasjes në e-mail, internet dhe intranet,
- (ii) ka bërë mirëmbajtjen e infrastrukturës për internet/intranet, shtrirjen e kablllove, kyçjen e tyre në kabinetet e switch-ave, dhe përcaktimi i porteve, ka krye shërbime softuerike dhe harduerike për shfrytëzuesit komunal: instalimi dhe konfigurimi i sistemeve operative, programeve aplikative, printerëve etj., konfigurimi i kompjuterëve për operim funksional në rrjetë, identifikimi dhe

- zgjdhja e problemit të sistemit operativ, identifikimi dhe zgjidhja e problemeve harduerike, identifikimi dhe zgjidhja e problemeve në rrjetin lokal (LAN) etj.
- (iii) Është kujdesur për siguri në teknologji informatike, në rrjeta, aparate, sisteme dhe programe të cilat punojnë dhe ruajnë të dhëna të ndjeshme. Është bërë kontrollimi dhe mbikëqyrja e sistemit, vlerësimi i rreziqeve, zbulimi, raportimi dhe ballafaqimi me incidentet e dyshuara të sigurisë në teknologji informatike,
 - (iv) në dhomën e serverëve janë vendosur 3 Serverë: Serveri kryesor i intranetit, Serveri ndihmësi intranetit dhe Proxy Serveri,
 - (v) Është mirëmbajtur softueri i intranetit; janë regjistruar punëtorët, mirëmbajt sistemi i postës elektronike (lokale), është mirëmbajt menaxheri i fajllave, është bërë menaxhimi i bazave të shënimeve, është bërë caktimi i të drejtave të shfrytëzuesve të intranetit në bazë të obligimeve që kanë ata brenda për brenda komunës,
 - (vi) me qëllim të rritjes së sigurisë në rrjet dhe për funksionim më të mirë të Serverëve, është bërë instalimi i MS Windows 2003 Server në të dy serverët e intranetit, instalimi i serverëve HP dhe DELL
 - (vii) është vendosur versioni i ri i intranetit i cili mundëson komunikimin e shpejtë dhe efikas dhe menaxhimin e shpejtë të kërkesave të qytetarëve.
 - (viii) është dizajnuar aplikacioni softuerik për Drejtorinë e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit i bazuar në ëeb teknologjinë, i cili është i lehtë për përdorim. Ky aplikacion është punuar nga zyrtarët e teknologjisë informatike në komunë dhe do të kryejë këto funksione: regjistrimin e kompanive, shtypja e lejeve të punës për biznese, shtypja e aktvendimeve për licencë të biznesit, gjenerimi i raporteve në bazë të fushave të ndryshme të kërkimit, dizajnimi i tabelave për tarifatat vjetore për ushtrimin e veprimtarive etj. Aplikacioni do të integrojë fillimisht edhe të dhënat të cilat do të jenë në dispozicion nga ana e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

h. Zyra për kthim

Zyra për kthim është angazhuar që komunitetet minoritare të kenë qasje të mira në shërbimet publike dhe në institucionet komunale. Zyra për kthim gjatë vitit 2008 ka mbajtur 24 takime me përfaqësuesin e UNMIK-ut për Komunën e Prishtinës ku është diskutuar mbi punën dhe aktivitetet e zyrtarëve të zyrës komunale për kthime. Po ashtu janë mbajtur 3 takime me 'Grupin komunal punues për kthim' ku janë diskutuar: puna e këshillit komunal të lokalizimit dhe integritit, vizitat në teren për identifikimin e pronave të të zhvendosurve, puna e zyrtarit komunal të kthimeve, rezultatet e vizitave në vendet ku tani banojnë të zhvendosurit në Serbi, shqyrtimi i kërkesave/ankesave të përfaqësuesve të shoqatave të zhvendosurve, të bashkësive multi-etnike dhe organizatave ndërkombëtare etj.

Zyra ka pasur 5 takime me zyrtarët e UNHCR-së, ku janë diskutuar kërkesat dhe gjendja e komunitetit Ashkali dhe Rom, gjendjen e familjeve serbe të cilët jetojnë në qytetin e Prishtinës, koordinimi i punëve në mesë të zyrtarëve për kthime dhe organizatave tjera ndërkombëtare, puna e nëngrupit punues për kthimin e të zhvendosurve serbë në fshatin Kolovicë. Zyra për kthim ka mbajtur 10 takime me Komitetin për Komunitete në të cilat janë shqyrtuar këto çështje: raportet e punës të zyrtarëve të zyrës së komuniteteve në Graçanicë, njoftimi me punën e zyrtarëve të zyrës komunale të kthimit, shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të pjesëtarëve të komuniteteve etj. Janë organizuar edhe takime të shumta me përfaqësues të organizatave dhe institucione të ndryshme si UNMIK, UNDP, OSCE, IOM, Mercy Corps, MAPL, MKK, DRC, KFOR, SHPK etj. Me ndihmën e UNDP-së, zyra për kthim ka arritur të ndërtoj/riparoj disa shtëpitë për personat e zhvendosur.

Zyra ka organizuar 20 vizita pronave, shtëpive dhe banesave të të zhvendosurve dhe të kthyerve Serb, Ashkali dhe Rom. Nëngrupi punues për kthimin e të zhvendosurve në pjesët rurale të Veriut dhe të Jugut të Prishtinës ka organizuar 4 takime në lidhje me kthimin e të zhvendosurve. Zyrtarët për kthime kanë marrë pjesë në 8 trajnime të organizuar nga UNHCR dhe UNMIK.

i. Zyra për komunitete

Zyra e komuniteteve është kujdesur për komunitetet jo shumicë në Komunën e Prishtinës në pajtim me kompetencat që ka dhe në koordinim me eprorët dhe shërbimet kompetente. Në pjesën e administratës së përgjithshme kjo zyrë ka punuar në pajtim me rregullativat në fuqi duke promovuar tolerancën dhe barazinë. Mjetet e alokuara financiare janë shfrytëzuar në harmoni me buxhetin dhe me procedurat komunale. Në ndarjen e mjeteve për investime kapitale rëndësi i është dhënë sidomos fshatrave. Zyra për komunitete ka mbajtur mbledhje të rregullta me Administratorin e Komunës. Zyra ka pasur aktivitete dhe kontakte sipas kërkesës së përfaqësuesve të fshatrave, të bashkësive, të ndërmarrjeve, të policisë, të UNMIK-ut, të KFOR-it, të OSCE-së, të organizatave joqeveritare e të tjerë. Në përgjithësi bashkëpunimi u zyrës për kthim me organet e tjera të Komunës së Prishtinës ka qenë i mirë dhe pritet që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në vitin 2009.

Në Shërbimin për administratë të përgjithshme dhe financa në vitin 2008 kanë punuar 20 punëtorë (nga 21 sa ka qenë në vitin 2007 pasi një punëtorë me marrëveshje e ka shkëputur marrëdhënien e punës). Shërbimi ka pasur kontakte të rregullta me zyrën për bashkësitë pakicë në Prishtinë me qëllim të shqyrtimit të problemeve të bashkësive pakicë.

Për Zyrën për komunitete janë ndarë 4.1% e buxhetit të Komunës së Prishtinës dhe atë:

- 139,581 € për investime kapitale,
- 76.481 € për mallra dhe shërbime,
- 16,816 € për komunali dhe
- 57,856 € për pagat e punëtorëve.

j. Departamenti i prokurimit

Gjatë vitit 2008, departamenti i prokurimit ka zhvilluar 336 aktivitete të prokurimit në krahasim me 290 sa ishin në vitin 2007. Kriteret bazë të tenderimit janë përcaktuar në Ligjin e Prokurimit siç janë: shfrytëzimi efikas i mjeteve, menaxhimi sa më ekonomik, jo diskriminimi dhe transparenca. Në bazë të kërkesave të drejtorive, janë kontraktuar punë, furnizime, shërbime, projekte dhe konkurse në shumën prej 19,228,767 €. Në procedurë, të shpallura apo në fazën e vlerësimit janë prokurime në vlerë të paralogaritur prej 2,558,340 €. Gjithsej aktivitete të prokurimit të kontraktuara dhe në procedurë kapin vlerën prej rreth 21.8 milion €, kurse në vitin 2007 ishin 15.1 milion €, ose për 44% më shumë.

Në vijim janë paraqitur llojet e aktiviteteve të prokurimit të kontraktuara dhe në procedurë. Prej tyre, 79% kanë qenë për projekte kapitale. Kjo përqindje është më e lartë nëse llogariten disa mallra si investime kapitale pasi e kanë kohën e përdorimit më të gjatë se një vit.

Përshkrimi	Shuma	%
Furnizime me mallra	2,677,500	12%
Shërbime (projekte, shërbime dhe mirëmbajtje)	1,921,352	9%

Konkurse	54,150	0%
Projekte kapitale	17,134,106	79%
Total	21,787,108	100%

Siç paraqitet në vijim, në 97% të rasteve të prokurimit, proceduara e përdorur në prokurim ka qenë ‘procedurë e hapur’ përmes tenderimit publik.

Përshkimi	Shuma	%
1. Procedurë e hapur	21,218,233	97.4%
2. Procedurë e kufizuar	33,600	0.2%
3. Konkursi i Projektimit	54,150	0.2%
4. Procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës, procedurë e kufizuar, kuotim i çmimeve	481,122	2.2%
Total	21,787,105	100.0%

Në tabelën në vijim është paraqitur pjesëmarrja e drejtorive në prokurimet e përgjithshme (të kontraktuara dhe në procedurë):

Drejtoritë	Shuma	%
Administrata dhe personeli	2,857,120	13.1%
Arsimi	5,312,130	24.4%
Financa	73,797	0.3%
Infrastruktura	8,782,760	40.3%
Shërbimet publike	2,116,758	9.7%
Shëndetësia	1,080,500	5.0%
Urbanizmi	1,459,683	6.7%
Zyra për komunitete	104,355	0.5%
Total	21,787,103	100.0%

Projektet më të rëndësishme kapitale të kontraktuara apo të proceduara gjatë vitit 2008 me vlera prej mbi një milion € janë:

- Ndërtimi i objektit komunal – punët përfundimtare, që pritet të përfundoj në fund të majit të vitit 2009,
- Ndërtimi i unazës së qendrës – faza e parë nga Xhamia e Llapit deri te rruga “Ahmet Krasniqi”, që do të përfundoj deri në fund të prillit të vitit 2009,
- Ndërtimi i rrugës Slivovë – Viti e Marecit, pritet të kryhet në muajin prill 2009,
- Ndërtimi i Gjimnazit “Xhevdet Doda” që do të përfundoj në fund të gushtit të vitit 2009,

Gjatë vitit 2008, në dy raste operator ekonomik kanë ushtruar ankesa kundër vendimeve të Departamentit të Prokurimit. Në të dy rastet KRPP i ka aprovuar zgjedhjet që i ka propozuar komuna si zgjedhje të drejta. Gjatë vitit 2008, Departamenti i Prokurimit ka dhënë mbi 1,800 dosje të tenderëve Operatorëve Ekonomik të interesuar.

Në hapjen e tenderëve janë angazhuar si anëtarë të komisioneve rreth 900 zyrtar komunal. Mbi 900 zyrtarë të tjerë janë angazhuar në vlerësimin tenderëve, të cilët kryesisht kanë qenë ekspert të Komunës të lëmive përkatëse varësisht nga natyra e projekteve. Departamenti i Prokurimit në bazë të raporteve zyrtare të Organeve Mbikëqyrëse dhe komisioneve të pranimit, ju ka shqiptuar dënime Operatorëve Ekonomik të pa përgjegjshëm për vonesa në kryerjen e punëve dhe ka marrë masa tjera në përputhje me ligjet në fuqi.

IV. REALIZIMIT I BUXHETIT

1. Shpenzimet buxhetore

Në kuadër të përmbushjes së objektivave të përcaktuara dhe përpjekjeve për realizimin sa më të plotë të shpenzimeve buxhetore, Komuna e Prishtinës ka përmbyllur realizimin e buxhetit për vitin 2008 në shkallë prej 91% (shih shtojcën 1 dhe 2 të këtij Raporti). Ky realizim është dukshëm më i madh krahasuar me vitin 2007 kur ka qenë 69%, ku si rezultat i mbajtjes së zgjedhjeve lokale dhe qendrore kishte rënë aktiviteti investiv në pjesën e dytë të vitit 2007.

Fondi i shpenzimeve buxhetore është përbërë nga grandet qeveritare dhe nga arkëtimet komunale. Prishtina është nën një presion të madh të migrimit social pas luftës, prandaj ndarja e grandeve në bazë të numrit të popullsisë, sipas vlerësimeve, nuk shkoi në favor të zgjidhjes së shumë problemeve me të cilat u ballafaqua Kryeqyteti. Prishtina në vitin 2008 mori pjesë në të hyrat vetanake që mbledhën të gjitha komunave me 38%, kurse nga Qeveria mori në formë të grantit të përgjithshëm vetëm 16% të grantit total të ndarë komunave. Tatimi në pronë për kokë banori në Prishtinë u realizua 10.57 €, krahasuar me 5.68 € sa ishte mesatarja në nivel vendi.

Realizimi i buxhetit nga kategoritë ekonomike përmban:

- a) Pagat dhe mëditjet;
- b) Mallrat dhe shërbimet;
- c) Shpenzimet komunale;
- d) Investime kapitale dhe
- e) Subvencionet dhe transferet.

Fondi për paga dhe mëditje është mbuluar nga mjetet e grantit bazuar në numrin e të punësuarve në administratë për vitin buxhetor 2008.

Fondet për mallra dhe shërbime janë shpenzuar në nivel të atyre të planifikuara. Cilësia e këtyre fondeve ka qenë më e ulët, për shkak të rritjes së çmimeve, prandaj janë përballuar më pak blerje në krahasim me ato të parapara. Shpenzimet vjetore në këtë kategori janë përfshirë nga grandit dhe fondi i të hyrave vetanake.

Shpenzimet komunale siç janë: energjia elektrike, uji, mbledhja e mbeturinave, ngrohja dhe shërbimet telefonike janë realizuar 98% nga ato të planifikuara dhe janë siguruar nga grandit dhe të hyrat.

Investimet kapitale si fushë më relevante dhe ndikuese në thithjen e shpenzimeve të buxhetit, shpreh performancën e realizimit të projekteve kapitale në infrastrukturë urbane dhe rurale. Mjetet e planifikuara në këtë fushë janë gati tërësisht nga të hyrat vetanake, nga granti stimulus dhe një shumë simbolike nga granti qeveritar. Karakteri i projekteve më së shumti ka përfshirë projektet në infrastrukturë si urbane ashtu edhe rurale. Investimet në këtë kategori janë realizuar rreth 95%, duke përfshirë investimet në arsim, shëndetësi, zyrën lokale të komuniteteve dhe administratë.

Subvencionët kanë përfshirë mbështetjet e ndryshme me karakter ekonomik (në bujqësi), social, kulturor dhe sportiv, dhe kanë përfshirë një fushë të gjerë dhe të diversifikuar të aktiviteteve. Ato janë mbuluar tërësisht nga të hyrat vetanake.

2. Të hyrat buxhetore

Në vitin 2008 janë realizuar të hyra në shumë prej 36,651,431 € nga këto burime:

- të hyrat nga granti i përgjithshëm në shumë 5,798,927 €
- të hyrat nga granti për arsim në shumë 10,116,581 €
- të hyrat nga granti për shëndetësi në shumë 3,270,036 €
- të hyrat vetanake 17,465,887.

Krahas këtyre të hyrave buxhetore, është realizuar një bashkëpunim me ministritë e linjës dhe me organizata ndërkombëtare për të investuar projekte nga fushat e tyre. Kështu, në vitin 2008 janë siguruar edhe **9,454,573 €** mjete jashtë buxhetore për këto projekte:

- 1) Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal: 385,000 €;
Projekti: Punët përfundimtare në ndërtesën e Komunës 250,000 €, Softweri për Administratë 100,000 € dhe ndërtimi i zyrës së Bashkësive Lokale 35,000 €.
Projekti: punët përfundimtare në ndërtesën e re të Komunës;.
- 2) Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit: 3,540,000 €
Projektet: Pjesëmarrje në ndërtimin e rrugës Slivovë - Viti e Marevcit 540,000 € dhe ndërtimi i rrugës Dheu i Kuq-Hajkobillë-Gllogovicë 3,000,000 € me pjesëmarrje të Komunës.
- 3) Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë: 5,398,953€
Projektet: Shkolla e Mesme në Qamëri 1,810,620 €, Shkolla e Mesme e TI 2,008,365 €, pjesëmarrje për Gjimnazin Xhevdet Doda 400,000 € dhe Shkolla Fillore në Bardhosh 1,180,588 €.
- 4) SIDA: 40.000 €, në fushën e arsimit dhe kulturës.
- 5) Banka Botërore 50,000 në fushën e arsimit dhe kulturës
- 6) KFOR-i Finlandez dhe Karabinierët Italian: 40,000 në fushën e arsimit dhe kulturës.

Pjesa më e madhe e këtyre projekteve vazhdon të realizohet edhe në vitin 2009, mirëpo fondet janë siguruar në vitin 2008. Në bazë të këtyre fondeve shtesë, në vitin 2008 është rritur kapaciteti investues i komunës me rreth 70% krahasuar me buxhetin fillestar të investimeve kapitale për vitin 2008 që ka qenë 13,347,062 €.

3. Të hyrat vetanake të realizuara në vitin 2008

Të hyrat e grumbulluar gjatë vitit 2008 janë 17,465,887 € ose 16% më shumë se sa planit vjetor i Komunës për të hyra vetanake prej 15 milion €. Nga MEF është përcaktuar korniza prej 14 milion €, prandaj në krahasim me vlerësimet e MEF tejkallimet janë në nivelin prej 26%. Krahasuar me vitin 2007, rritja e të hyrave është për 46% që flet për një performansë dukshëm më të mirë të arkëtimit të të hyrave vetanake. Tabela e të hyrave vetanake për vitin 2008 dhe krahasimi me vitin 2007 është paraqitur në shtojcën 2 të këtij raporti.

Burimet kryesore në arkëtimin më të madh të të hyrave janë rritja e efikasitetit në procedimin dhe lëshimin e lejeve urbanistike dhe rritja e arkëtimit nga tatimi në pronë. Përkushtimi më i madh për shtrirjen horizontale të arkëtimit të të hyrave duhet të vijojë në fushën e licencave në biznes dhe në inspeksion.

Sipas burimeve specifike, shkalla e rritjes është:

- | | |
|--|-----|
| • Rritja totale e të hyrave vetjake | 46% |
| • Rritja nga lejet e ndërtimit | 71% |
| • Rritja e arkëtimit nga tatimi në pronë | 47% |
| • Rritja e të hyrave nga shfrytëzimi i sipërfaqeve publike | 78% |

- a. **Të hyrat nga lejet e ndërtimit.** Rritja e këtyre të hyrave është rezultat i masave për zvogëlimin e informaliteteve urbane, rritjes së vetëdijes së qytetarëve për kërkim të lejeve të ndërtimit si dhe i uljes së tarifave për ndërtime nga Kuvendi i Komunës. Të hyrat janë më të mëdha për 27% nga shuma e planifikuar kurse për **71% më shumë** krahasuar me vitin 2007.
- b. **Të hyrat nga tatimi në pronë** – Trendi i rritjes së këtyre të hyrave gjithnjë po vijon në shkallë ngritjeje. Në vitin e fundit arkëtimi i tatimit në pronë është realizuar mbi bazën e planifikuar për 36%. Nëse krahasojmë periudhën fiskale nga viti 2007 në vitin 2008, **rritja është 47%**. Në vitin 2009 pritet vazhdim i ngritjes së shkallës së arkëtimit, duke marrë parasysh efektet e uljes së normës tatimore.
- c. **Të hyrat nga shfrytëzimi i sipërfaqeve publike** – Këto të hyra janë rritur për 78% krahasuar me vitin 2007.
- d. **Të hyrat tjera** – janë realizuar mbi nivelin e paraparë dhe mbi atë të vitit të kaluar.
- e. **Të hyrat nga administrata** (Shërbimi i ofiqarisë) – Përafërsisht janë parashikuar dhe tejkualuar rreth 5%.
- f. **Të hyrat nga Shërbimi kadastral dhe gjeodezik** – Nga shërbimet operative për matje gjeodezike në terren dhe regjistrimet kadastrale, këto taksa kapin shumë e realizimit 89%. Krahasuar me vitin paraprak shënojnë rritje për 25%.
- g. **Të hyrat nga Inspekcioni** – Rritja e këtyre të hyrave tregon veprimet e ndërmarra për kujdesin dhe ngritjen e vetëdijes në lëmin e ndërtimit, si për nga aspekti i personave fizikë dhe juridikë. Nëse këto veprime i shprehim në efekte monetare, atëherë shkalla e ngritjes është mbi 63%. Ndërsa në anën e vlerësimit me vitin 2007, paraqet rritjen për 22%.
- h. **Të hyrat nga transaksioni i pronës** - Me rastin e shitë-blerjeve të patundshmërisë ndërmjet personave fizikë dhe juridikë, taksa e cila rezulton paraqet të hyrat në këtë fushë. Raporti në mes planifikimit dhe realizimit është tejkualuar për rreth 20%, ndërsa nëse krahasojmë vitin 2008 me vitin 2007, është rritur për 22%.
- i. **Të hyrat nga licenca në biznes** - Nga raportimi krahasues i vitit 2007 me vitin 2008, janë rritur për rreth 42%. Mirëpo këto të hyra janë nën nivelin e parashikuar.
- j. **Të hyrat nga gjobat në trafik** – Këto të hyra arkëtohen drejtpërdrejt nga niveli qendror dhe në shkallë përqindjeje distribuohen nëpër komuna.
- k. **Të hyrat nga arsimi (institucionet parashkollore)** – Mjetet e arkëtuar nga participimi i fëmijëve në çerdhe, iu dedikohet atyre për shërbime më të mira dhe kujdes me të qëndrueshëm.
- l. **Të hyrat nga shërbimet shëndetësore (participimet)** – Këto të hyra shënojnë rritje për 14% në krahasim me planin. Mblidhen nga participimet e personave në vizita mjekësore.
- m. **Të hyrat nga participimet / donacionet, taksa rrugore, Agjensioni i Pyjeve dhe gjobat nga gjykatat**, shënojnë rënie si në krahasim me planin, po ashtu edhe në krahasim me vitin e kaluar.

V. AKTIVITETI I DREJTORIVE SIPAS FUSHAVE

1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT

a. Sektori i Punëve të Përgjithshme dhe Juridike

i) Personeli

Në vitin **2007** në administratën komunale kanë qenë të punësuar 712 shërbyes civil, ndërsa më datë 31.12.2008 administrata komunale ka pasur gjithsej 680 të punësuar (siç është paraqitur në tabelën në vijim). Gjatë kësaj periudhe marrëdhënien e punës e kanë ndërprerë 37 shërbyes civil dhe janë punësuar 5 të tjerë (që jep diferencën prej 32 punëtorëve më pak në vitin 2008 krahasuar me vitin 2007). Këto të dhëna janë në bazë të listës së pagave për dhjetor 2007 dhe dhjetor 2008.

Marrëdhënia e punës sipas fuqisë ligjore iu është ndërprerë 9 shërbyesve civil dhe kanë ndërprerë marrëdhënien e punës edhe 22 shërbyes të tjerë civil. Në procedurë disiplinore i është ndërprerë marrëdhënia e punës 1 shërbyesi civil dhe kanë vdekur 5 shërbyes civilë.

Në të njëjtën periudhë, në administratën e Komunës, respektivisht në shërbimin e inspektionit janë punësuar 3 shërbyes civil dhe në zyrën e auditimit të brendshëm 2 shërbyes civil.¹

Në harmoni me Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, Sektori i punëve të përgjithshme dhe juridike, është angazhuar në kryerjen e këtyre punëve :

- Rregullimi, sistemimi dhe ruajtja e dokumentacionit personal të të punësuarve në organet e administratës komunale;
- Aktiviteti që ndërlidhet me realizimin e të drejtave dhe detyrimeve të të punësuarve në shërbimin civil komunal, nga lëmi i marrëdhënies së punës;
- Përpilimi i kontratave të punës për shërbyesit civilë, përcjellja e afateve të tyre, evidentimi dhe futja e tyre në dosjet personale të të punësuarve;
- Përpilimi i aktvendimeve për pushim vjetor të shërbyesve civil;
- Përpilimi i aktvendimeve për pushim pa pagesë ;
- Përpilimi i vërtetimeve të ndryshme për nevojat e shërbyesve civil;
- Futja dhe ruajtja në kompjuter e të dhënave (dosjeve) personale, të shërbyesve civil;
- Përpilimi dhe ruajtja e regjistrave të drejtorive komunale si dhe punë të tjera administrative.

Punët e përshkruara si më lart personeli i administratës i ka kryer në bazë të rregullativës juridike, respektivisht në bazë të Rregullores nr. 2001/36, dhe në mbështetje të Urdhëresës administrative nr. 2003/02 për implementimin e Rregullores 2001/36.

Nga të punësuarit, 29% janë femra dhe 71% meshkuj, kurse shikuar nga niveli profesional, nga numri i përgjithshëm 24% janë me fakultet. Nga drejtoritë janë adresuar kërkesa për

¹ Në Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit janë punësuar 6 shërbyes civilë, por këta kanë filluar punën në janar 2009 dhe nuk kanë qenë në listë të pagave deri më 31.12.2008.

pranimin e ekspertëve të urbanistikës, gjeodetë, ingjinerë, juristë për çështje pronësore. Po ashtu janë identifikuar nevoja të mëdha për forcimin e shërbimeve të sportelit me njerëz të rinj, por pranimi i njerëzve të rinj ka qenë i kufizuar me kornizën afatmesme buxhetore.

Numri i përgjithshëm i shërbyesve civil në drejtori dhe institucione tjera për vitin 2008

	Përshkimi	Nr. i përgjith	Kualifikimet				Struktura etnike				gjinia	
			Fak.	Shk. e lartë	Shk. e mesme	Stafi mbësht.	Shqiptar	Serb	Turq	Te tjere	M	F
1.	Zyra e Kryetarit –shefi i personelit	2	2	-	-	-	2	-	-	-	2	-
2.	Drejtorja e Admin.dhe Personelit	133	15	10	89	19	125	2	5	1	100	33
3.	Drejtorja për pronë	9	5	1	3	-	9	-	-	-	6	3
4.	Drejtorja për Fin. Ekon.dhe Zhv.	76	28	6	41	1	75	-	1	-	51	25
5.	Drejtorja për Urb.Kad.dhe Mb.Mj.	75	27	4	43	1	75	-	-	-	39	36
6.	Drejtorja për Shend.dhe Mirq.Soc.	17	12	-	5	-	17	-	-	-	11	6
7.	Drejtorja për Infrastruktur lokale	13	3	1	9	-	13	-	-	-	7	6
8.	Drejtorja për Ars. dhe Kulturë	29	26	1	2	-	27	-	1	1	12	17
9.	Drejtorja për Shërb.Pub.dhe EC.	52	18	7	27	-	52	-	-	-	42	10
10.	Zjarrfiksat	117	2	4	111	-	92	25	-	-	115	2
11.	Zyra e komunitetit ne Graçanice	21	1	3	15	2	-	20	-	1	16	5
12.	Zyra per marrdh.me Publikun	1	1	-	-	-	1	-	-	-	1	-
13.	Zyra ligjore	4	3	-	1	-	4	-	-	-	2	2
14.	Zyra per Prokurim	6	4	-	2	-	6	-	-	-	6	-
15.	Zyra e Pranimit	9	5	-	4	-	9	-	-	-	3	6
16.	Zyra per teknologji informative	2	-	-	2	-	2	-	-	-	2	-
17.	Zyra per kthim	2	1	-	1	-	1	1	-	-	1	1
18.	Njësia e audit.të brendshëm	3	3	-	-	-	3	-	-	-	2	1
19.	Avokatura Publike	5	3	-	2	-	5	-	-	-	2	3
20.	Nepunes per Kom. dhe ceshtje gjin.	1	1	-	-	-	1	-	-	-	-	1
21.	Pilot –Projekt –Financa	39	1	-	38	-	33	6	-	-	23	16
22.	Institucioni i Mon.dhe Muz.Rajonal	6	-	-	3	3	6	-	-	-	3	3
23.	Arkivi Hist. i Qytetit te Prishtines	7	2	-	5	-	7	-	-	-	3	4
24.	Biblioteka “Hivzi Sylejmani”	15	1	2	11	1	15	-	-	-	7	8
25.	Qendra e pioniereve	7	3	-	4	-	7	-	-	-	4	3
26.	Teatri “Dodona”Prishtine	18	3	-	13	2	18	-	-	-	15	3
27.	Shtepia e Kultures Graçanice	10	-	2	8	-	-	9	-	1	9	1
28.	Shtepia e Kultures Hajvali	1	-	-	1	-	1	-	-	-	1	-
	GJITHESEJ	680	170	41	440	29	606	63	7	4	485	195

ii) Shërbimi i byroteknikës

Aktiviteti i këtij shërbimi kryesisht ka të bëjë me shumëzimin dhe fotokopjimin e materialeve të ndryshme për nevojat e drejtorive të Komunës. Janë shumëzuar dhe fotokopjuar gjithsej 526,766 kopje (në vitin 2007 ishin fotokopjuar 484,006 kopje) ose 11% më shumë.

b. Sektori për shërbime profesionale të Kuvendit dhe të Ekzekutivit

Sektori për Shërbime profesionale të Kuvendit dhe të Ekzekutivit gjatë periudhës raportuese ka kryer këto punë :

- Punët administrative në përgatitjen e materialeve (vendimet, rregulloret etj.) për mbledhje të Kuvendit, Ekzekutivit dhe Komiteteve;

- Përkthimi, lekturimi dhe shpërndarja e materialeve;
- Përgatitja respektivisht nxjerrja e ekstrakteve nga procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit dhe të Komiteteve;
- Përgatitja e rregulloreve, vendimeve dhe i akteve tjera të miratuara nga Kuvendi, nga Këshilli i Drejtorëve dhe nga organet tjera.
- Informimi publik lidhur me aktivitetin e Kuvendit dhe të Ekzekutivit të Komunës ;
- Bashkërenditja e punëve të komiteteve.

c. Sektori teknik

Punët dhe shërbimet të kryer në suaza të këtij sektori janë :

- mirëmbajta e ndërtesës;
- sigurimi i objekteve të Komunës;
- mirëmbajta e higjienës në objektet e Komunës;
- shërbime hoteliere nga byfeja e Komunës për nevojat e zyrtarëve të Komunës;
- punët teknike lidhur me funksionimin dhe mirëmbajtjen e teknologjisë informative në objektet e Komunës;
- organizimi dhe menaxhimi i shfrytëzimit të automjeteve zyrtare;
- menaxhimi i rrjetit të telefonisë fikse.

Sa u përket shpenzimeve specifike të shfrytëzimit të automjeteve dhe të shpenzimeve të telefonit gjatë kësaj periudhe janë bërë kursime evidente si:

- Gjatë vitit 2008 janë kaluar 450,351 km me automjete të komunës (krahasuar me 576,533 km në vitin 2007) që është 22% më pak se në vitin 2007;
- Shprehur në karburantet e shpenzuara, në vitin 2008 janë shpenzuar 61,486 litra karburante (krahasuar me 74,744 litra të shpenzuara gjatë vitit 2007) që është për 13,258 litra më pak ose 18% më pak;
- Për nevoja të komunës kanë qenë në shfrytëzim gjithsej 43 automjete. Automjetet, sipas vendimit të Kryetarit të Komunës, në pajtim me Këshillin e Drejtorëve janë shfrytëzuar nga garazha dhe kanë qëndruar në garazhën e Komunës;
- Shpenzimet e byfesë janë zvogëluar për 26% krahasuar me vitin 2007. Këto shpenzime gjatë vitit 2008 kanë qenë 21,894 € (ose 7,616 € më pak se një vit më parë);
- Shpenzimet e telefonisë fikse gjatë vitit 2008 kanë qenë 39,727 € dhe krahasuar me një vit më parë janë zvogëluar për 7,691 € ose për 16%.

d. Sektori i bashkësive lokale

Në Komunën e Prishtinës funksionojnë gjithsej 36 bashkësi lokale (BL), prek të cilave 20 i takojnë zonës urbane dhe 16 të tjera zonës rurale. Punët e ndërlidhura me bashkësitë lokale janë:

- takimet me kryetarët e BL-ve ku është diskutuar lidhur me punët dhe aktivitetin e gjithëmbarshtëm në kuadër të këtij sektori;
- bashkëpunimi me drejtoritë e Komunës lidhur me realizimin e projekteve të ndryshme infrastrukturale; organizimi i tubimeve me qytetarë nëpër bashkësitë lokale, ku është diskutuar lidhur me kërkesat e qytetarëve, që ndërlidhen me projekte të ndryshme infrastrukturale;
- nga zyrat e BL-ve janë kryer shërbime administrative sipas kërkesave të qytetarëve, përkritazi me realizimin e të drejtave të tyre, nga fusha të ndryshme;

Sipas kërkesave të palëve nga të gjitha zyrat e BL-ve janë lëshuar gjithsej 56,123 vërtetime të llojeve të ndryshme, siç janë: vërtetime për rregullimin e dokumentacionit personal, vërtetime për rregullimin e të drejtave të qytetarëve nga lëmi social, vërtetime për rregullimin e të drejtave të qytetarëve tanë me qëndrim të përkohshëm në botën e jashtme etj.

e. Sektori i gjendjes civile

Angazhim me prioritet i këtij sektori gjatë periudhës raportuese ka qenë mbledhja, zgjidhja, ruajtja, mirëmbajtja, sistemimi, mbikëqyrja dhe vërtetimi i të gjitha lëndëve që kanë të bëjnë me gjendjen civile të palëve që ndërliken me lindjet, martesat, vdekjet etj.

Për shkak të kërkesave të palëve që kanë shënuar rritje të vazhdueshme në kuadër të këtij sektori, është aplikuar orari i zgjatur i punës deri në orën 18:00 dhe veç kësaj është punuaredhe të shtunave. Gjithashtu në funksion të shkarkimit të administratës së Komunës, janë bërë parapërgatitje për hapjen e katër zyrave të gjendjes civile, në disa lagje të qytetit të cilat pritet të funksionalizohen në fillim të vitit 2009.

Në periudhën janar-dhjetor 2008, shërbimi i ofiçarisë ka kryer 30,670 regjistrime ose korigjime të ndryshme si më poshtë:

• Regjistrime të reja në LAL (Libri amzë i të lindurve)	9,910
• Regjistrimet e mëvonëshme në LAL	12,614
• Regjistrimet e reja në LAM (libri amzë i të martuarve)	1,456
• Regjistrimet e mëvonshme në LAM	1,836
• Regjistrimet e reja në LAV (libri amzë i të vdekurve)	1,815
• Regjistrimet e mëvonshme në LAV	1,089
• Korigjime, përmirësime, regjistrime të mëvonshme në LAL, ndërrim emrash apo mbiemrash	1,950

Nga shërbimi i ofiçarisë janë lëshuar 90,342 dokumente si vijon:

• Certifikata të lindjes	54,757
• Certifikata martesore	12,051
• Certifikata të vdekjes	8,484
• Certifikata të statusit martesor	3,416
• Vërtetime që personi është në jetë	1,083
• Deklaratë për bashkësinë familjare	4,086
• Certifikata të lindjes për jashtë vendit	5,855
• Certifikata të martesës për jashtë vendit	455
• Certifikata të vdekjes për jashtë vendit	155

Lidhur me lindjet, martesat dhe vdekjet që kanë ndodhur jashtë Kosovës gjatë kësaj periudhe, shërbimi i ofiçarisë ka kryer 3,017 regjistrime/dokumente:

- Regjistrime speciale në LAL	2,624
- Regjistrime speciale në LAM	328
- Regjistrime speciale në LAV	65

f. Njësia monitoruese - Zyra pritëse

Gjatë vitit 2008 në Komunën e Prishtinës janë pranuar dhe trajtuar gjithsej 229,620 lëndë.

Përkufizimi përfundimtar i lëndëve të pranuar është sipas këtyre kanaleve:

- Intranetit	33,996 lëndë
- Librit të protokollit	12,552 lëndë
- Sektorit të gjendjes civile	90,342 lëndë
- Sektorit për Kadastër dhe Gjeodezi	36,607 lëndë
- Sektorit të bashkësive lokale	56,123 lëndë

Nëse lëndët e trajtuara i krahasojmë me ditët e punës, atëherë rezulton se çdo ditë pune në komunën e Prishtinës janë trajtuar 998 lëndë, kurse nga sektori civil janë lëshuar mesatarisht 400 certifikata të ndryshme në ditë. Vlen të theksohet se në ditët e verës, kur janë kërkesat e mëdha për certifikata të lindjes, gjatë ditës lëshohen deri në 1,000 certifikata dhe dokumente të tjerë.

Lëndët e pranuara nëpërmjet intranetit

DREJTORITË	Pranuara	Refuzuara	Miratuara	Hedhura poshtë	Njoftim	Informim	Përgjigje	Kushte urbanistike	Leje ndërtimi	Konkluzë	E pakryer
Administrata dhe personeli	2.345	43	2.125	14	14	5	4				140
Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave	18.010	277	16.797	20	16	2					898
Drejtorja e Urbanizmit, Kadastrit dhe mbrojtjes së mjedisit	7.408	336	5.521	40	288	432	9	193	85	7	497
Drejtorja për Shëndetësi dhe mirëqenie sociale	940	172	600	49	68	1	4				46
Drejtorja për Arsim dhe Kulturë	1.099	145	534		153	40	126				101
Drejtorja e Shërbime Publike	3.312	15	2.484	19	669	26	21				78
Drejtorja për Infrastrukturë Lokale	206		8	1	149	11	12				25
Drejtorja e Pronës	676		407		23	4	5				237
	33.996	988	28.476	143	1.380	521	181	193	85	7	2.022

Në vitin 2008 janë pranuar gjithsej 33,996 lëndë nëpërmjet intranetit, në krahasim me 28,099 lëndë sa ishin pranuar në vitin 2007, ose 20% më shumë. Lëndët e pakryera marrin pjesë me 5.5% në numrin e përgjithshme të lëndëve të pranuar përmes intranetit.

Lëndë të pranuar në Librat e Protokollit kanë qenë 12,552:

- Vërtetime për mbajtës të familjes dhe ndihmë juridike981
- Libri i ekspeditimit në vend 1,921
- Libri i dorëzimit të postës personalisht 1,966
- Libri i faturave hyrëse 1,073
- Libri i Protokollit (konkurse, D.Z, etj) 6,611

Sektori i gjendjes civile ka pranuar dhe lëshuar 90,342 certifikata të lindjes, të vdekjes si dhe certifikata të qytetarëve kosovar të lindur në botën e jashtme.

Lëndët e sektorit për kadastër, si lëndë të terrenit, certifikata të RDPP-së (fletë poseduese) kopje të planit, certifikata të ndihmës sociale etj. kanë qenë 36,607.

Sektori i bashkësive lokale ka procesuar 56,123 lëndë.

Me gjithë masat e ndërmarra për zgjatjen e kohës së punës gjatë verës dhe për punë ditëve të shtuna, nuk është arritur të zvogëlohen pritjet e palëve në sportel për certifikata të lindjes. Sportelet i ka rënduar sidomos lëshimi i dokumentacionit civil, letërnjoftimeve dhe pasaportave nga Minsitria e Punëve të Brendshme në lokale të Komunës, në kohën kur po lëshohen për herë të parë dokumentet e Republikës së Kosovës në afat prej 10 vjetësh. Për të tejkaluar këtë janë inicuar masat për hapjen e zyrave të reja në katër zona të qytetit, përpos qendrës e cila do të vazhdoj të mbetet në lokalet e Komunës.

2. DREJTORIA E EKONOMISË, FINANCAVE DHE ZHVILLIMIT

Në kuadër të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave në vitin 2008 kanë funksionuar Sektori i Ekonomisë (Shërbimi i planifikimit dhe i biznesit), Sektori i inspektionit të tregut dhe të bujqësisë, Sektori i tatimi në pronë dhe Sektori i zhvillimit rural, të bujqësisë dhe pylltarisë.

a. Sektori i buxhetit

Ky sektor për vitin 2008, ka punuar në planifikimin e buxhetit dhe të hyrave për vitin fiskal 2008, koordinimin e punëve në mes drejtorive për përgatitjen e buxhetit, përgatitjen e raporteve javore, mujore dhe vjetore, përgatitjen dhe plotësimi e formularëve buxhetor për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave - Departamentin e buxhetit komunal dhe përgatitjen e rrjedhës së parasë.

Drejtorja është marrë me kontimin e të gjitha shpenzimeve ditore, listës së pagave, nënshkrimit të pagesave ditore për thesar, barazimin e sintetikës me analitikën për arkë, depo dhe byfe, përgatitjen e raporteve periodike financiare dhe zotimin e mjeteve në bazë të kërkesave që dalin nga planifikimi buxhetor dhe verifikimi i tyre në bazë të planeve të drejtorive.

Drejtorja ka bërë regjistrimin e të hyrave ditore nga inkasantët, regjistrimin e të hyrave vetanake në sistemin "Free Balanc", barazimin mujor në mes bankës dhe thesarit, pagesat e faturave me para të gatshme, pranim - dorëzimin e parasë së imët në arkë dhe regjistrimi i ditarit të arkës, përcjellja e procedurave të pagesave të sistemit "free balanc", alokimi i mjeteve, shpenzimi i mjeteve nga granti dhe të hyrat vetanake.

Përgatitja e buxhetit është bërë për këto kategori ekonomike: (a) për projekte kapitale, (b) për shërbime të ndryshme, (c) për furnizim me mallra, (d) shpenzime të tjera komunale dhe (e) subvencione.

Po ashtu, në vitin 2008 drejtorja është marrë me pranimin dhe përgatitjen e dokumentacionit për pagesë - thesar; ngarkimin dhe shkarkimin e bllok-pagesave (arkëtarë dhe sportelistë); punë të tjera për palët e treta (Administrata Tatimore, korrespondencat me Ministri, bankë etj.); përgatitjen e raporteve për ndarjen e drejtë financiare, përcjelljen e shpenzimeve për Administratë, ZLK dhe Brigadën e Zjarrfikësve; barazimet e mjeteve të alokuar, krahas raporteve të kontabilitetit dhe "free balancit".

b. Sektori i ekonomisë


Niveli i realizimit të të hyrave nga biznesi për këtë periudhë përcaktohet nga numri i vogël i inspektorëve të tregut, mospërputhshmërisë së adresave të biznesit si dhe lëshimet e tjera administrative dhe procedurale gjatë fazës së regjistrimit të shoqërive tregtare në MTI - Agjencioni për regjistrimin e bizneseve, rënia ekonomike etj.

Në Sektorin e transportit të udhëtarëve me auto-taksi janë bërë ndryshime cilësore dhe vizuale, duke zbatuar Rregulloren mbi këtë lloj transporti ku qytetarëve u është ofruar siguri, si dhe transparencë lidhur me shfrytëzimin e këtij lloji të shërbimit, me vendosjen e shenjave identifikuese mbi auto-veturat.

Gjatë periudhës raportuese ky sektor ka realizuar projektin e pestë me radhë investiv për komunitetin e biznesit. Në projektin e përbashkët të Sektorit të Ekonomisë dhe KFOR -it finlandez janë investuar **75,000 €**. Nga ky projekt kanë përfituar 11 biznese të ndryshme nga të gjitha komunitetet. Projekti ka pasur për qëllim mbështetjen e bizneseve të vogla me makina, vegla pune dhe pajisje tjera për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Është realizuar projekti “Trajnimi i të rinjve të papunë në ndërmarrësi” me qëllim të aftësimit të të rinjve për të filluar biznesin vetanak si një mundësi reale e vet punësimit. Me këtë projekt janë ofruar trajnime profesionale në lëmin e menaxhimit të ndërmarrjeve të vogla, bazat e kontabilitetit financiar, marketingut, hartimi i biznes-planit si dhe të planit strategjik. Projekti ka zgjatur 36 ditë pune, ku janë aftësuar mbi 60 pjesëmarrës.

Gjatë vitit 2008 ky sektor janë kryer 3,375 lëndë, në krahasim me 1,860 sa ishin një vit më parë. Janë lëshuar 2,160 leje pune, 1,158 vërtetime dhe 49 njoftime. Paraqitja grafike e lëndëve të kryera dhe krahasimi me vitin paraprak është paraqitur në figurën në vijim



c. Sektori i inspektionit

Inspekcioni i tregut dhe bujqësisë ka kryer 5,517 kontrollime, prej të cilave 3,860 në tregti, 836 në hotelieri, 323 në zejтари dhe 498 në shërbime tjera. Krahas kësaj ka bërë 3,432 procesverbale.

Inspekcioni ka asgjësuar mallra në vlerë prej 64,381 €. Malli i asgjësuar ka qenë: 28,659 litra ushqim dhe 17,041 kg ushqim.

Po ashtu, është larguar mall nga qarkullimi i tregut për shkak të dëmtimit, thyerjes dhe prishjeve të ndryshme në vlerë prej 61,801 €. Vlera e mallit të konfiskuar (ushqimor dhe jo ushqimor si pemë dhe perime, telefona, tekstil, lëndë shpërthyesë – piroteknike etj.) ka qenë në vlerë rreth 1,080 €.

Inspekcioni ka shqiptuar këto masa administrative:

- Urdhëresa me shkrim.....	907
- Vendime për mbyllje të lokaleve, asgjësim të mallrave.....	94
- Fletëparaqitje për kundërvajtje,	126
- Fletëparaqitje penale.....	03
- Ankesa dhe kërkesa të qytetarëve – të kryera.....	23
- Vërejtje, ftesa dhe sugjerime të dhëna.....	169

Inspekcioni ka mbyllur përkohësisht 75 lokale dhe 3 lokale i ka mbyllur përhërë.

Janë pranuar 738 lëndë për dhënien e pëlqimeve për plotësimin e kushteve minimale teknike nga kompetenca e inspekcionit të tregut, të cilat janë:

• Të kryera	679 lëndë
• Në procedure	24 lëndë
• Të refuzuara	7 lëndë
• Kontestuese	28 lëndë

Shuma e mjeteve të inaktuara nga dhënia e pëlqimeve ka qenë 81,682 €, ndërsa shuma e mjeteve të llogaritura e të pa inkasuara është 25,211 €.

d. Sektori i tatimit në pronë

Gjatë vitit 2008 është inkasuar tatim në pronë për vitin 2008 në shumë prej 4,272,122 €. Janë lëshuar 54,374 fatura të tatimit në pronë dhe është bërë regjistrimi i formularëve të pronave - objekteve të reja për 1,790 raste, dhe ri-regjistrim për 152 raste. Janë përgatitur vërejtje të fundit për pagimin e tatimit në prone për 36,400 persona,

Gjatë këtij viti janë:

- regjistruar në kompjuter pagesat e tatimit në pronë të bëra nga tatimpaguesit për 18,483 pagesa;
- përmirësuar në kompjuter zonat dhe kategoritë për 1,240 raste,
- përmirësuar në kompjuter adresat (rrugëve) 740 raste,
- regjistruar në kompjuter vendimet sipas ankesave për 1,017 raste,
- përmirësuar gabimet eventuale teknike në faturat e tatimit në pronë 440 raste,
- pranuar 8,457 kërkesa për vërtetimin e paguar për tatimin në pronë, prej tyre janë miratuar 8,297 dhe janë të pa përfunduara edhe 160 kërkesa të bartura në vitin vijues, etj.
- Janë lëshuar 8,457 vërtetime për kryerjen e obligimit tatimor.

Në kuadër të mbledhjes së shënimeve, është bërë matja dhe regjistrimi i objekteve të paregjistruara gjatë vitit paraprak 1,790 raste, janë reregjistruar 140 objekte banesore, afariste, industriale dhe garazhe dhe është bërë kontrollimi i 122 objekteve në terren në bazë të ankesave të tatimpaguesve.

e. Zyra e shpërndarjes

Janë shpërndarë 46,000 letërkujtesa tatimore dhe 36,400 vërejtje të fundit për mos pagimin e tatimit. Bordi i ankesave ka pranuar 1,017 ankesa nga tatimpaguesit, prej të cilave janë shqyrtuar 766 dhe janë lëshuar aktvendimet ose janë dërguar komisionet në terren për shqyrtimin e atyre ankesave që ka qenë e nevojshme edhe shikimi i gjendjes.

Shërbimi i transakcionit të pronës ka pranuar 4,316 lëndë. Të gjitha palët e këtyre lëndëve kanë kryer pagesën ndaj komunës në afatin e duhur, përveç 83 rasteve për të cilat obligimi financiar ndaj komunës ende nuk është kryer.

Drejtoria ka hasur në vështirësi për kryerjen e punëve, prej të cilave duhet theksuar:

- mungesa e lokalit pasi në një zyrë punojnë 10-15 punonjës;
- programi kompjuterik është shumë jo efikas për dhënien e gjendjes për tatimpaguesit;
- mungojnë numrat e objekteve banesore, lokaleve afariste, lokaleve sportive dhe objekteve të tjera;

Për aftësimin e stafit, gjatë vitit 2008 janë dërguar në trajnime 10 punonjës për përvetësimin e programit të ri i cili po përgatitet nga ekspertët suedez. Në vitin 2008 këtij shërbimi i është shtuar edhe taksa për regjistrimin e automjeteve motorike që ka krijuar edhe vështirësi shtesë nëpër sportele, pasi që për secilin regjistrim të automjetit duhet të nxirret edhe gjendja tatimore.

f. Sektori për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural

Në vitin 2008, sektori i bujqësisë ka përcjell rregullisht aktivitetet në lëmin e bujqësisë në lidhje me mbjelljet pranverore dhe vjeshtore, përcjelljen dhe organizimin e korrje-shirjeve, vlerësimin e gjendjes si dhe dëmet e shkaktuara në bujqësi dhe në pyjet e Komunës së Prishtinës dhe Parkun Regional ‘Gërmia’.

Në vijim janë disa projekte të realizuara dhe shumat e shpenzuara përkatëse:

- Projekti “Furnizimi me farë gruri dhe plehra minerale”	33,600 €
- Projekti “Furnizimi me pajisje bletare”	4,300 €
- Projekti “Eliminimi i qenve endacakë”	17,372 €
Gjithsej:	55,272 €

Janë zhvilluar edhe këto aktivitete që lidhen me lavërtari:

- Planprogrami dhe realizimi i mbjelljeve pranverore
- Planprogrami dhe realizimi i mbjelljeve vjeshtore
- Raport për korrje-shirje
- Pjesëmarrja në hartimin e strategjisë lokale-rurale si dhe këshillimi i fermerëve
- Shqyrtimi i kërkesave për prerje të drunjve në pyjet private
- Vlerësimi i dëmeve në Parkun Rajonal të Gërmisë
- Projekti “Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura” nga APK-ja
- Shqyrtimi i themelimit të vend-gjuetive

Bazuar në Planprogramin e mbjelljeve pranverore për vitin 2008, në komunën e Prishtinës janë mbjellë gjithsej 2,751 ha me kultura pranverore si:

- Tërshërë	73 ha
- Misër	2,056 ha
- Bimë foragjere	175 ha

- Perime	85 ha
- Patate	302 ha
- Fasule si monokulturë	15 ha
- Elb pranveror	45 ha

Në mbjelljet vjeshtore 2008/2009, janë planifikuar gjithsej 2,735 ha me tri kulturat si: grurë, elb vjeshtor dhe bimë foragjere, mirëpo për shkak të çmimit të lartë të farës dhe plehut, janë mbjellë 2,522 ha.

- Grurë	2,380 ha
- Elb vjeshtor	113 ha
- Bimë foragjere	29 ha

Projekti “Furnizimi me farë gruri dhe plehra minerale“: janë ndihmuar 200 fermer me nga 150 farë gruri, gjithsej 30.000 kg farë gruri dhe 200 fermer me nga 150 kg plehra minerale, gjithsej 30.000 kg plehra minerale. Shpërndarja është bërë në Bashkësitë Lokale: Bardhosh, Besi, Barilevë, Prugovc, Dabishevc, Koliq, Keqekollë, Marevc, Mramor, Llukar, Thanishtë dhe Shkabaj .

Korrje –shirjet e vitit 2008: Kanë marrë pjesë 36 kombajna, çmimi i korrjes sillej prej 100€/ha pa lidhëse. Rendimentet e grurit dhe cilësia e tij ishin të mira (4,900 kg/ha). Faktorët që kanë ndikuar në ngritjen e rendimenteve janë kushtet atmosferike të mira që kanë mbretëruar prej mbjelljes së grurit e deri në korrjen e tij.

Projekti “Furnizimi me pajisje bletare“: Gjatë muajit shtator, në bashkëpunim në mes të Komunës së Prishtinës dhe shoqatës “Heifer International Kosova “, është realizuar projekti i përbashkët në lëmin e bletarisë. Shoqata ka bërë dhurimin e shoqërive të bletëve, ndërsa Komuna e Prishtinës e ka bërë furnizimin me pajisje bletare. Është bërë shpërndarja e pajisjeve bletare në fshatrat Hajkobillë dhe Dabishevc.

Projekti “Eliminimi i qenve endacakë“: Eliminimi i qenve endacakë është realizuar gjatë muajve shkurt dhe mars 2008 (operacioni i parë). Gjatë këtij aksioni janë eliminuar gjithsej 700 qenë endacakë, është përfshirë tërë qyteti dhe ky aksion ka rezultuar të jetë i suksesshëm dhe pa asnjë aksident të shkaktuar. Realizimin e këtij projekti e ka bërë NPK ”Hortikultura”. Në periudhën kohore tetor - dhjetor gjithashtu ka vazhduar operacioni i dytë për eliminimin e qenve endacakë, me që rast janë eliminuar gjithsej 598 qenë, brenda vitit janë eliminuar gjithsej 1,290 qenë endacakë.

Pjesëmarrja në hartimin e Strategjisë lokale – rurale si dhe këshillimi i fermerëve: Pjesëmarrja në hartimin e “Strategjisë lokale për zhvillimin rural”, në bashkëpunim me Agjencionin Evropian dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural. Në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është realizuar projekti “ Dhënia e këshillave fermerëve “ me ç’rast u janë dhënë këshilla fermerëve të tri kategorive: fermerëve ekzistues, fermerëve gjysmë komercial dhe fermerëve komercial.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është realizuar edhe pilot-projekti “ Statistikat në bujqësi“.

Në lëmin e pylltarisë përveç aktiviteteve tjera, janë realizuar edhe këto punë:

- Në bashkëpunim me Agjensionin Pyjor të Kosovës (APK) në komisionin e përbashkët, është bërë shqyrtimi i kërkesave të bëra nga ana e qytetarëve për prerje në pyjet private.
- Vlerësimi i dëmeve në Parkun Rajonal Gërmia është realizuar gjatë muajit dhjetor dhe vlera e dëmeve është 17,022 m³ masë drunore.
- Inventarizimi i dëmeve vjetore në APK- Njësia në Prishtinë, është kryer gjatë muajve nëntor-dhjetor 2008.
- Projekti “Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura“ nga APK-ja, Njësia në Prishtinë, në sipërfaqe prej 15 ha është realizuar gjatë muajve tetor – nëntor 2008.
- Mbikëqyrja e mirëmbajtjes së gjelbërimit në Parkun e Qytetit Tauk-Bahçe dhe Arbëri.

3. DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRËS DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Drejtorja e Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUKMM) përbëhet prej katër sektorëve: Urbanizmit, Kadastrës, Inspektion Ndërtimor dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Fushë veprimtaria dhe punët e kësaj drejtorie janë bazuar kryesisht në zbatimin e rregullativës Ligjore nga lëmia e planifikimit dhe rregullimit hapësiror, ndërtimit të objekteve investive, inspektionit të ndërtimit, mbrojtjes së mjedisit, kadastrit e gjeodezisë etj.

b. Sektori i Urbanizmit

Ky sektor përbëhet nga Shërbimi i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimit e Banimit. Puna parësore e shërbimi të planifikimit ka qënë përgatitja, koordinimi dhe qasja në hartimin e planeve rregulluese, të përcaktuara me detyrat programore për periudhën raportuese, duke përfshirë përgatitjen e detyrave programore, përgatitjen e materialit tenderues, përgatitjen e metodologjisë së mbajtjes së punëtorive, përgatitjen dhe mbajtjen e ekspozitave, diskutimeve publike të këtyre planeve rregulluese, deri në miratimin e tyre. Në bazë të këtyre detyrave programore i është dhënë prioritet hartimit të këtyre projekteve dhe planeve rregulluese: Kodra e Trimave I, Kodra e Trimave II, Qyteza Pejton, Vellusha, Qendra, Medrese Çamëria, Zona Ekonomike, Prishtina e Re (është punuar profili urban), Muhagjerët (duke u punuar plani rregullues) dhe Dardania (plan rregullues në përfundim).

Përmes kësaj shërbimit janë përcaktuar lokacione adekuate sipas kërkesave. Janë konsultuar plane ekzistuese urbanistike dhe organet ekzekutive kompetente të komunës lidhur me statusin pronëso-ro-juridik të atyre lokacioneve. Janë përgatitur propozimet grafike, në bazë të të cilave janë përgatitur propozim vendimet me arsyetimet përkatëse, të cilat janë prezantuar për shqyrtim në Këshillin e Drejtorëve, Komitetin për Planifikim, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe në Kuvendin e Komunës. Lokacionet e përcaktuara gjatë periudhës raportuese janë:

- Lokacioni për SH.M. të Teknologjisë Informative,
- Lokacioni për Sh.F. në lagjen Kalabri,
- Lokacioni për SH.M. ‘Xhevdet Doda’,
- Lokacioni për SH.F. në lagjen Sofali,
- Lokacioni për Stacionin e Metrologjisë,
- Lokacioni për terrene sportive në lagjen “Kodra e Diellit”
- Lokacioni për terrene sportive në lagjen “Arbëri
- Lokacioni për ndërtimin e QMF-së Lagja “Arbëria”
- Lokacioni për ndërtimin e QMF-së Lagja e “ Muhagjerëve”,
- Lokacioni për ndërtimin e QMF-së Lagja “Velani”,

- Lokacioni për ndërtimin e QMF-së Lagja “ Vreshta”,
- Lokacioni për ndërtimin e Gjimnazit të përgjithshëm në lagjen “Medrese-Çamëria”
- Ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit nr. 01-031-3379 dt.03.12.2004 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit Teatrit të Operës dhe Baletit dhe Galerisë së Arteve në Prishtinë,
- Lokacioni për ndërtimin e Bibliotekës së Qytetit në Lagjen “Dardania “ ,
- Ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Policisë së Kosovës.

Për lokacionet e caktuara për ndërtimin e objekteve për të cilat ka qenë investitor komuna, janë përgatitur materialet, detyrat dhe programet projektuese për hapjen e tenderëve, është marrë pjesë në komisionet për vlerësimin e dokumentacionit të ofertave , si dhe është bërë menaxhimi i realizimit- ndërtimit të këtyre objekteve nga personeli civil profesional i kësaj drejtorie.

Gjatë periudhës raportuese, kanë arritur **2138** kërkesa ndërsa të bartura nga viti paraprak kanë qenë **120**. Përmbajtja e kërkesave ka qenë kryesisht caktimi i lokacioneve, lëshimi i lejeve urbanistike për caktimin e kushteve urbanistike-teknike, lejeve ndërtimore, vendosjen e objekteve të përkohshme, informacione për destinimet e sipërfaqeve në planet përkatëse urbanistike, caktimin e dispozitave, kushteve dhe kritereve sipas planeve të caktuara rregulluese, për rrënimin e objekteve ekzistuese, për ndërtimin e destinimit të përdorimit të objekteve ekzistuese, kërkesa tjera për kushtet për rregullimin e hapësirës, si dhe kërkesa dhe kundërshtime me përmbajtje të ngjashme. Vendosja e kërkesave në shumicën e rasteve është bërë në bazë të konkluzioneve përfundimtare e disa të tjera janë vendosur në bazë të informacioneve, përgjigjeve etj.

Shërbim i ndërtimit dhe banimit angazhimin dhe detyrat i ka realizuar në pajtim me programin e punës për periudhën raportuese si në vijim:

- Planifikimin/projektimin e projekteve të infrastrukturës;
- Mbikëqyrja e objekteve për të cilat investues është Kuvendi Komunal;
- Marrja pjesë në pranimet teknike të objekteve dhe punimeve të kryera;
- Marrja pjesë në komisionet për vlerësimin e tenderëve;
- Përgjigjja e lëndëve që kanë të bëjnë me infrastrukturë dhe rindërtim;
- Marrja pjesë komisionet-ekipet e eksperteve të caktuar nga bordi i drejtorëve;
- Përgatitja e vendimeve për komisione për pranim teknik dhe leje të përdorimit;
- Kontrollimi i projekteve që dorëzohen për leje të ndërtimit (pjesa e stabilitetit dhe instalimeve)

Janë vizituar-incizuar gjendja faktike e rrugëve të caktuara si prioritet nga Kuvendi Komunal. Janë përgatitur detyrat projektuese dhe janë përcjellë punimi i projekteve për rrugët:

- Rruga unazore “Unaza Qendër “ pjesa perëndimore
- Rruga unazore “ Unaza e brendshme” pjesa perëndimore dhe lindore
- Rruga “B “ (Mati I) së bashku me rrugët lidhëse
- Rrugët që lidhë rrugën “Tirana “ me rrugën “Ahmet Krasniqi”
- Rruga “Tahir Zajmi”
- Rruga “Enver Maloku”,
- Rruga pjesa e parë e Aeroportit dhe rruga paralele Prishtinë- Shkup (Kalabria)
- Rruga Prapashticë - Hajkobilë
- Rruga Dabishevc – Gllogovicë
- Rruga Llukar – Siquevë
- Rruga Bardhosh- Milevc

Është bërë mbikëqyrja e objekteve për të cilat investues ishte Kuvendi i Komunës

- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit “ Qendra e Pionerve “ në Gërmi,
- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në lagjen Vreshta,
- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në lagjen Mati 1,
- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në fshatin Glllogovicë,
- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në fshatin Dabishevc,
- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në lagjen Halitaj,
- Mbikëqyrja e fasadimit të objektit të Komunës në Arbëri,
- Mbikëqyrja e aneksit të çerdhes "Gëzimi Ynë" në Ulpianë, ky objekt është mbikëqyr në bashkëpunim me DASHK të K.K. të Prishtinës,
- Mbikëqyrja e punimeve në objektin e trashëgimisë kulturore “Hamami i Madh”,
- Mbikëqyrja e urës në rrugën “Vëllezërit Fazliu”,
- Mbikëqyrja e rrethojës për ambasadën Amerikane në Arbëri,
- Mbikëqyrja e ndërtimi të rrugëve “ Mbreti Bardhyl” dhe “Maliq Pashë Gjinolli” në Prishtinë,
- Mbikëqyrja e rrethojës së objektit të QMF në lagjen Bregu i Diellit
- Mbulimi i terasës në I.P “Gëzimi Ynë”,
- Koordinimi i punëve dhe kontaktet me institutet për mbrojtjen e monumenteve,
- Mbikëqyrja- bashkëmenaxhimi i konsecionit për fshatin ndërkombëtar,
- Mbikëqyrja e objektit për banim social,
- Ndërtimi i shtëpive individuale (të vërshimeve),
- Ndërtimi i shkollës në lagjen Podaj Koliq,
- Fasadimi i Objekteve të Bulevardit Nëna Terese (Faza II),
- Kanalizimi në objektin e Komunës,
- Ndërtimi i terenit sportiv Llukar,
- Rregullimi i ujësjellësit në lagjen Kolovicë,
- Rregullimi i kanalizimit fekale në fshatin Vranidoll,
- Rregullimi i kanalizimit fekale në fshatin Lebanë,
- Ndërtimi i rrugës “Sheshi i Arbërit”,
- Ndërtimi i kanalizimit atmosferik përgjat rrugës “Isa Kastrati “,
- Ndërtimi i QMF në lagjen Vreshta,
- Ndërtimi i QMF në lagjen Velani,
- Ndërtimi i QMF në fshatin Hajvali,
- Sanimi i rrafshit rrëshqitës në lagjen “Velani “,
- Renovimi i kulmeve te disa shkollave pjesa e I dhe II,
- Riparimi i aneksit të sallës KK Prishtinë,
- Gëlqerosja e disa shkollave të Komunës së Prishtinës pjesa I dhe II,
- Renovimi i nyjeve sanitare në disa shkolla te Komunës së Prishtinës.

Gjatë periudhës raportuese zyrtaret e kësaj Drejtoria kanë marrë pjesë në hapjen dhe vlerësimin e tendereve të organizuar nga zyra e prokurimit të komunës si dhe në pranimin teknik të objekteve dhe punimeve të kryera. Është punuar në hartimi i programeve për donator si në vijim: Unaza e Brendshme, Pjesa perëndimore e “Unazës Qendër”, “Zona Ekonomike” dhe ndërtimi i shkollave (në bashkëpunim me DAKS). Gjatë kësaj periudhe raportuese ju është përgjigjur kërkesave që kanë të bëjnë me infrastrukturë si: pëlqime urbanistike, detyra projektuese etj. Të gjitha këto janë paraqitur në tabelën në vijim. Po ashtu janë kontrolluar të gjitha projektet që kanë kërkuar leje të ndërtimit dhe të shëndrrimit. Kontrollimi konsiston në vlerësimin e cilësisë së hartimit të projektit sipas normave dhe standardeve të aplikueshme.

Kërkesat dhe procedimi i tyre nga shërbimi i ndërtimit dhe banimit

Përshkrimi	L.urbanistike	L.ndërtim.	Lokacin	Shëndrrimet	Ankesa	Të ndrysh.	Total
Leje urbanistike	197		2	15	3		217
Leje ndërtim		91		1			92
Informime	268		22	6	5	400	701
Refuzime	262		2	30	47	106	447
Plotësim lënde	17	7				28	52
Njoftim	28		3	3	3	84	121
Pezullime	34	2					36
Pëlqime	29					41	70
Në procedure	47	12	5	6	12	106	188
Ankesa në sh.II	15					83	98
Korrigjime		10				2	12
L.përdorimi		6					6
Shtëpitë e vërsh.	19						19
Vler. deme lufte						29	29
Cak. Pikave						38	38
Total	916	128	34	61	70	921	2,130

Në vitin 2007 ishin lëshuar 91 leje urbanistike dhe 59 leje ndërtimore, prandaj këtë vit te lejet urbanistike shënohet një rritje e dyfishtë kurse te lejet e ndërtimit për rreth 55%.

c. Sektori i Kadastrit dhe Gjeodezisë

Në Sektorin për Kadastër dhe Gjeodezi janë parashtruar një numër më i madh i kërkesave nga persona fizik dhe juridik. Krahasuar me vitin 2007 që kishte 22.079 lëndë, gjatë kësaj periudhe raportuese kanë arritur 40,755 kërkesa prej të cilave 40,610 janë zgjidhur dhe 145 janë ende në procedurë (diferenca në mes të këtij numri dhe numrit të paraqitur tek ‘zyra pritëse’ prej 36,607 është për shkak se disa lëndë nuk kanë shkuar përmes zyrës pritëse por drejt në këtë sektor). Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2007 numri i kërkesave është rritur për **84.5%**. Nga ky sektor gjatë kësaj periudhe raportuese janë inkasuar taksa në shumë prej **541,762 €**. Ky organ për nevojat e Komunës së Prishtinës ka punuar të gjitha kërkesat që janë me prioritet për Komunën e Prishtinës.

Llojet e shërbimeve të kryera gjatë vitit 2007 dhe 2008

Nr.	Llojet e Shërbimeve	2007	2008
1	Fletë Poseduese	7,110	8,897
2	Kopje Plani	6,732	8,409
3	Ndërrimet dhe bartjet në operat	3,224	3,310
4	Lëndët e terrenit	684	865
5	Certifikata të ndryshme	3,342	17,909
6	Lëndë të intabulimit-hipotekave	864	1,280
7	Vërtetime	123	85
	Gjithsejtë	22,079	40,755

d. Sektori i Inspektionit të Ndërtimit

Sektori i inspektionit të ndërtimit, gjatë periudhës raportuese, punët dhe detyrat i ka kryer në pajtim me dispozitat ligjore: Ligjit për Ndërtim, Udhëzimeve Administrative dhe akteve tjera që e rregullojnë punën e këtij sektori. Me riorganizimi e organeve të administratës, Sektori i Inspektionit të Ndërtimit që nga fillimi i këtij viti, vepron në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Gjatë vitit raportues, e kryesisht në periudhën e parë të vitit, sektori ka hasë në vështirësi në kryerjen e punëve nga shkak i numrit të pakt të inspektorëve të ndërtimit, mosangazhimi i mjaftueshëm në përmbushjen e detyrave nga disa prej tyre, gjë që rezultoi me mosvazhdimin e kontratave të punës për 6 zyrtar. Në kontekst të saj, vështirësi tjetër ka qenë edhe mosvazhdimi i kontratës me kohe i operatorit për rrënimin e objekteve pa leje. Përkundër kësaj, me riorganizim të ri, angazhim maksimal dhe vendosmëri, numri i mbetur i punëtorëve, ka treguar rezultate më të mira, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak.

Si rezultat i këtij angazhimi, kemi evidentimi e të gjitha objekteve të filluara pa leje ndërtimore, janë kryer procedurat ligjore konform obligimeve dhe kompetencave si: Lende të evidentuara 818, të bartura nga viti paraprak 44, dmth gjithsej 862 lende, prej të cilave: 635 urdhër ndalesa, 135 Aktvendime për rrënim (prej të cilave 91 objekte janë rrënuar, ndërsa për 44 të tjera kemi të bëjmë me aktvendime të marra në gjashtë mujorin e parë të vitit 2008 dhe nuk janë ekzekutuar për arsye të cekura më lartë).

Vlen të përmendet se gjatë kësaj periudhe, kompania private "Parc- Projekt" ka ndihmuar inspeksionin në evidentimin dhe përcjelljen e gjendjes në teren. Me angazhimin maksimal të këtij sektori është bërë nderprerja dhe futja nën kontroll të ndërtimeve. Ky angazhim këmbëngulës i këtij sektori ka ndikuar në vetëdijesimin e qytetarëve që të aplikojnë dhe të pajisen me leje ndërtimore. Vlen të theksohet se ndërtimet pa leje kanë qenë më të shprehura në zonat të cilat nuk kanë qenë të mbuluara me plane rregulluese (Prishtina e Re, Qagllavice, Bardhosh, Hajvali, Matiqan.)

e. Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit

Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit ka kryer punët në pajtim me detyrat programore duke u mbështetur në dispozitat ligjore të aplikueshme, rregullore dhe vendime të Kuvendit Komunal, kështu që gjatë periudhës raportuese ka bërë 330 kontrollime, 6 kërkesa dhe njoftime në lidhje me mbrojtjen e ambientit (ujit dhe ajrit) siç janë: kontrollimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, trotualet, ujërat e zeza, pastrimi i borës para lokaleve, kapakët e pusëve të ujërave atmosferike, kontinierët si dhe zhurmat e shkaktuara nëpër lokale afariste si dhe nga gjeneratorët. Sektori përballet me mungesë të stafit.

f. Çështje tjera

Gjatë angazhimit në kryerjen e detyrave të punës DUKMM është ballafaquar me vështirësi të natyrave të ndryshme. Një ndër pengesat serioze është mos hartimit i Planit Zhvillimor të Komunës, mungesa e Institutit për Planifikim hapësiror dhe urban, numri i vogël i bashkëpunëtorëve profesional (arkitekt, inxhinier, gjeodet, inspektor, jurist etj.), mungesa e ligjit për trajtimin e objekteve pa leje ndërtimi, mungesa e të dhënave të sakta statistikore (si regjistrimi i popullsisë), mungesa e standardeve dhe normativave (planifikimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes), atakimi enorm i hapësirave me ndërtime ilegale dhe uzurpimi i sipërfaqeve tokësore në pronësi të komunës gjë që ka vështirësi të planifikimit në ato hapësira, kufizimi i të drejtës së administrimit të komunës në tokën në pronësi të saj, mosekzistimi i organit implementues të planeve rregulluese, mungesa e gjeomedisë profesionale (digjitale), mungesa e kadastrit etazhor, rrjeti gjeodezik komunal i shkatërruar dhe i vjetruar.

4. DREJTORIA E SHËRBIMET PUBLIKE DHE EMERGJENCËS CIVILE

Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës Civile (DSHPEC) është përgjegjëse për mirëmbajtjen e shërbimeve publike-komunale, duke përfshirë mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve, ndriçimit publik, semaforët, sinjalizimin horizontal dhe vertikal, mirëmbajtjen e sipërfaqeve gjelbëruese, varrezave të qytetit, parqeve dhe krojeve publike, kanalizimit atmosferik të qytetit, transportit publik, menaxhimin e hapësirave publike dhe për menaxhimin e të gjitha situatave emergjente në Komunë. Segment i rëndësishëm i DSHPEC gjatë këtij viti ishte edhe inspektorati komunal, i cili zbaton të gjitha vendimet dhe rregulloret e komunës për kontrollin e trafikut dhe transportit publik, kontrollon hapësirat publike, zbatimin e aktvendimeve të ndryshme etj.

Të hyrat totale të kësaj drejtorie shërbimi gjatë vitit 2008 kanë qenë 775,045 € të specifikuar si më poshtë:

- Shërbimi i transportit 183,583 € (prej të cilave nga parkingjet e rezervuara 63,770 € dhe nga shërbimi i merimangës 107,013 €, nga parkingjet me koncesion 12,800 €),
- Shërbimi Energjetik 119,845 € dhe
- Shërbimi i hapësirave publike 381,878 € (prej të cilave nga 194 aktvendimet 93.477 €, nga komisioni për vendosjen e tavolinave 116,843 €, nga vendosja e shkallëve 7,157 €, nga qiraja nga kioskat 30,903 €, nga ngarkesa për AMM 133,497 € dhe të hyra nga Laura në Gërmi 89.737 €).

Të hyrat në vitin 2008 janë rritur për 297,145 € ose për 62 % në krahasim me vitin 2007.

a. Sektori i Shërbimeve Publike

i. Shërbimi i Transportit

Puna e Shërbimit të Transportit ka qenë kryesisht e përqendruar në aktivitetet rreth transportit publik, sinjalizimit në përgjithësi, parkingjeve, transportit-konfiskimit me merimangë, semaforëve, bashkëpunimit me kompaninë që është duke realizuar projektin “Asistencë transportit urban të Prishtinës”. Është përcjell në vazhdimësi mbarëvajtja e transportit publik në territorin e Komunës së Prishtinës dhe orari i operimit të transportit publik për linjat urbane si dhe linjat për Fushë Kosovë dhe fshatrat e Fushë Kosovës. Ky shërbim ka menaxhuar shërbimin e merimangë dhe parkingut në zonën industriale ku vendosen automjetet e konfiskuara nga policia. Janë dhënë në shfrytëzim (të rezervuara) vend-parkime për institucione shtetërore të vendit dhe të huaja pa pagesë, si dhe për subjekte fitimprurëse me pagesë. Po ashtu janë dhënë me koncesion parkingjet publike në shiritin e ndarë rrugor.

Në lidhje me sinjalizimin horizontal dhe vertikal, janë bërë rregullime të shenjave ekzistuese të dëmtuara nëpër rrugë të qytetit dhe vendosje të shenjave të reja në disa rrugë. Mjetet e shpenzuara për sinjalizimin horizontal dhe vertikal kanë qenë 67,742 €. Punët në sinjalizimin horizontal dhe vertikal të rrugëve janë duke vazhduar, varësisht prej nevojave të paraqitura në orientimin e komunikacionit apo riparimin e sinjalizimit ekzistues.

Ka vazhduar bashkëpunimi me kompaninë që është duke realizuar projektin ‘Asistencë transportit urban të Prishtinës’ që mbështetet nga Banka Botërore. Ky projekt ka për qëllim rritjen e nivelit të efikasitetit të punës të Njesisë së Transportit të qytetit të Prishtinës për të planifikuar, dizajnuar dhe implementuar programet e transportit dhe trafikut.

Shërbimi i transportit është marrë me lëndët e ndryshme si vijon: lëndë të pranuar dhe iniciuara 407, aktvendime 109, pëlqime 46, njoftime 197, kërkesa 20, dërgim i lëndëve 40, lëndë nga konfiskimi i automjeteve 3,600 etj. Në lidhje me vendparkimet, janë lëshuar 11 aktvendime për institucione pa pagesë dhe 16 aktvendime për subjekte me pagesë.

ii. Shërbimi i mirëmbajtjes së rrugëve dhe varrezave të qytetit

Ky shërbim ka bërë mirëmbajtjen dimërore të rrugëve dhe e trotuareve të qytetit të Prishtinës. Këto punë i kanë kryer kompania 'Toifor' e cila mirëmban rrugët e loto I (38 rrugë) dhe loto II (30 rrugë). Shuma e paguar kësaj kompanie ka qenë 56,770 €. Kompanie 'Pastrimi' mirëmban rrugët e loto III (53 rrugë) dhe është paguar 29,033 €. Kompania 'Noti' ka bërë grumbullimin e dheut dhe mbeturinave ndërtimore për të cilat punë është paguar në vlerë prej 6,000 €.

Kompania 'Pastrimi' ka bërë mirëmbajtjen verore të rrugëve dhe trotuareve të qytetit të Prishtinës në loton I, II dhe III. Kompania SHPK "Toifor" ka punuar në vazhdimësi ka bartur material të fortë ndërtimor – mbeturina, në Deponinë në Mirash afërsisht 50.000 m³. Është përgatitur projekti për pastrimin e rrjetit të kanalizimit atmosferik, furnizimi dhe montimi i grilave në rrugët me prioritet dhe është zgjedhur fituesi NP 'Metali'.

Për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve dhe trotuareve të qytetit të Prishtinës gjatë vitit 2008/2009 janë kontraktuar 'Toifor' loto I (78 rrugë) me vlerë 92,990 € dhe 'Pastrimi' loto II (88 rrugë) me vlerë 86,992 €. Për rrugët rurale janë kontraktuar VZ 'Company' loto I (12 rrugë) me vlerë 7,914 € dhe 'Dardani' Loto II (13 rrugë) me vlerë 8,870 €.

iii. Shërbimi energjetik

Për mirëmbajtjen e ndriçimit publik për vitin 2008 kanë qenë të siguruara mjetet nga Buxheti i Komunës së Prishtinës në shumë prej 91.092,00 €. Punët për mirëmbajtjen e ndriçimit publik i ka kryer 'Termomontimi'. Gjatë vitit vitit 2008 janë mirëmbajtur gjithsejtë 226 rrugë. Shuma e mjeteve të shpenzuara për mirëmbajtjen e ndriçimit publik ka qenë 88,942.00 €. Për mirëmbajtjen e semaforëve për vitin 2008 nga Buxheti i Komunës së Prishtinës janë siguruar mjetet në shumë prej 58,959 €. Punët i ka kryer kompania 'Jame' dhe janë shpenzuar 24.316 €.

Për shpenzimin e energjisë elektrike të ndriçimit publik dhe të semaforëve janë shpenzuar mjetet në shumë prej 229,204 €. Gjatë vitit 2008, shërbimi energjetik :

- ka përpiluar 36 oferta me para masë dhe paralogarit për dislokimin e rrjetit 0.4 kV të ndriçimit publik të ri në rrugët që janë ndërtuar ose janë në ndërtim. Gjatë lëshimit të Aktvendimeve për ndërtimin e kanalizimit kabllor energjetik, telefonik, shtrirjes së kabllove optike etj. janë inkasuar taksat në shumë prej 119,845.95 €.
- ka hartuar 12 detyra projektuese për punimin e projekteve të reja të rrugëve në qytet;

Ky shërbim ka bërë mbikëqyrjen e rregullt të rrugëve për dislokimin e rrjetit 0.4 kV, ndërtimin e kanalizimit kabllor energjetik dhe ndërtimin e ndriçimit publik , si vijon:

- Ndërtimi i kanalizimit kabllor, rekonstruimi i rrjetit 0.4 kV dhe ndërtimi i ndriçimit publik në rr. "Llapit" dhe "Malush Kosova" (vlera 78,256.42 €)
- Ndërtimi i ndriçimit publik i ri në rr. "Nëna Terezë" Rekonstruimi i rrjetit 0.4 kV në rr. "Vllëzërit Fazliu" me vlerë të kontraktuar prej 93,045.85 €

- Ndërtimi i ndriçimit publik (armaturave) në rr. “Vllëzërit Fazliu” me vlerë të kontraktuar prej 28,888.00 €
- Ndërtimi i rrjetit 0.4 kV dhe i ndriçimit publik në rr. “Andrea Gropa”, “Fazli Grajqevci” dhe “Bedri Pejani” me vlerë të kontraktuar prej 23,623.00 €
- Furnizimi dhe montimi i baterive industrial për semafora me vlerë të kontraktuar prej 21,868.00 €
- Dislokimi i rrjetit 0.4 kV dhe ndërtimi i ndriçimit publik në rr. “Andrea Gropa” me vlerë të kontraktuar prej 25,485.00 €

Përveç punëve ndërtimore janë përfshirë edhe punët elektrike të ndërtimit të kanalizimit kabllor energjetik, dislokimi i rrjetit 0.4 kV dhe ndriçimi publik në këto rrugë: Fuad Dibra’, ‘Dem Ahmeti’, ‘Rrexhep Xheli’, ‘Ismet Derguti’, ‘Ramë Govori’, ‘Aleksandar Moisiu’, ‘Unaza e Mbrendshme’, ‘Rasim Kiçina’, ‘Asllan Pireva’, ‘Hamzë Jashari’ dhe ‘Norbert Jokl’, ‘Ibrahim Kelmendi’, ‘Niket Dardani’, ‘Rahman Murati’, ‘Zejnel Bajraktari’, ‘Mbreti Piro’, ‘Selman Kadria’, ‘Sheshi i Arbërit’ dhe ‘Antigona Fazliu’.

iv. Shërbimi i Mbrojtjes së Ambientit

Përqendrimi i aktiviteteve të Shërbimit të Mbrojtjes së Ambientit ka qenë në mirëmbajtjen e sipërfaqeve gjelbëruese të qytetit, ngritjen e sipërfaqeve të reja dhe shqyrtimin e kërkesave (lëndëve) nga komuniteti. Në vitin 2008 është rritur për afër 10% sipërfaqja e gjelbëruar në Prishtinë në krahasim me vitin 2007. Në mirëmbajtje të sipërfaqeve gjelbëruese kanë qenë 453.587 m², të cilat kanë qenë të ndara në pesë zona të qytetit. Gjatë vitit 2008 në qytet është bërë rregullimi i sipërfaqeve të reja gjelbëruese në këto lokacione:

1. Në rr. “Mustafa Venhari”-Dardani;
2. Në rr. “Ilaz Kodra”, Dardani (përballë stacionit të autobusëve);
3. Sipërfaqët e Sheshi Idriz Seferi (ana e majtë dhe djathtë);
4. Sipërfaqja në rr. “Eqrem Çabeji” (te Qerdhja e fëmijëve);
5. Sipërfaqja në rr. “Agim Ramadani”;
6. Sipërfaqët përgjatë rrugës “Nënë Tereza” dhe “Dëshmorët e Kombit”;
7. Sipërfaqja te Unioni-përballë Kuvendit të Kosovës;
8. Sipërfaqja në rr. “Fehmi Agani”-te Qafa;
9. Bulevardi “Nënë Tereza”.

Njëkohësisht gjatë kësaj periudhe në rr. “Agim Ramadani”, Sheshin “Nënë Tereza”, Parkun e Qytetit dhe te Varrezat e Dëshmorëve është bërë mbjellja e luleve sezonale si dhe mirëmbajtja e tyre. Të gjitha këto punë të cekura më lartë janë realizuar nga NPK “Hortikultura”, të mbikëqyrura nga ky shërbim. Ky shërbim ka pranuar 120 kërkesa të cilat në afat ligjor i ka kryer.

v. Shërbimi për hapësira publike dhe reklama

Ky shërbim gjatë vitit 2008 është marrë me kërkesat për shfrytëzimin e hapësirave publike. Pasqyra e lëndëve është: lëndë të pranuar 518, lëndë të shqyrtuara 479, aktvendime 194, njoftime 321.

b. Sektori i inspektionit komunal dhe komunikacionit

Gjatë vitit 2008 është bërë riorganizimi i sektorit me pranimin e inspektorëve dhe referentëve komunal. Në këtë është shtuar efikasiteti në punë dhe janë parandaluar shumë

veprime në qytet të cilat për qëllim kanë pas degradimin dhe uzurpimin e hapësirave publike. Ka pasur koordinim jashtëzakonisht të mirë të punëve me inspektoratin e tregut, sanitar dhe të ndërtimit. Për shkak të mungesës së infrastrukturës ligjore në ushtrimin e kompetencave është hasur në probleme të terrenit të cilat kanë të bëjnë me kërkesat dhe ankesat e qytetarëve në lidhje me infrastrukturën dhe instalimet në banesat publike kolektive të specifikuar si vertikalet e kanalizimit, vertikalet e ujësjellësit, vertikalet e ngrohë sjellësit me nënstacionet shtëpiake, shkallët, liftet, dritaret, fasadat si dhe kulmet.

Punëtoret e këtij sektori kane kryer këto pune:

- Kontrollime-----	21582
- Procesverbale-----	3901
- Aktvendime -----	829
- Fletëparaqitje për gjykatë-----	531
- Kërkesa te palëve-----	829
- Njoftime te palëve me shkrim-----	810
- Aksione me SHPK-ne -----	256
- Fletëthirrje për palët-----	220
- Evidentim te panove –reklamave-----	721
- Largim te reklamave-panove-----	284
- Largim te shtyllave anti-parking dhe pengesa të betonit , rrethojave metalike --.....	306
- Largim te mbeturinave inerte-----	507 m ³
- Largim te objekteve montuese-kioskave-----	15
- Largim te kubëzave nga sip-publike-----	52 m ³
- Largim te tavolinave shërbyese nga sip-publike-----	103
- Evidentim te shfrytëzimit te hap-publike para lokaleve-----	225
- Shqiptimi i gjobave ne trafik me tiketë-----	65
- Konfiskim te automjeteve ne trafik-----	10
- Marrje pjesë ne te gjitha aksionet ne treg dhe sip-publike nga Dt.01.08.2008 deri me dt.31.12.2008	
- Largim te pengesave te ndryshme nga sipërfaqja publike dhe trotareve ne afërsi te tregjeve te qytetit -----	600
- Konfiskim te skarave për pjekje -----	40
- Konfiskim te tavolinave shërbyese ,subjekteve afariste -----	28
- Konfiskim te karrigeve para lokaleve,subjekteve afariste-----	91
- Largim te bonbolave te gasit -----	2
- Demolim te autolarjeve -----	4
- Demolim te platove para lokaleve-----	12

c. Sektori i Emergjencës Civile

Në këtë periudhë kohore janë hartuar dhe miratuar Plani kundër sëmundjes së shpezëve Hartimi i Planit emergjent për evakuimin e personelit nga ndërtesa e Kuvendit Komunal, Rregullorja për përbërjen, kompetencat dhe punën e Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Plani për vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë e ndryshme dhe natyrore për territorin e Komunës së Prishtinës. Po ashtu kemi qenë pjesëmarrës aktiv në Komisionin qeveritar për hartimin e Planit Kombëtar për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Udhëzimit Metodologjik për Vlerësimin e Rrezikut në territorin e Republikës.

Janë mbajtur kontakte të përhershme me TMK, SHPK,KFOR, Departamentin e Menaxhimit të Emergjencave, Kryqin e Kuq, Entin e Mjekësisë Emergjente, Bashkësitë Lokale etj. Një kujdes të posaçëm gjatë këtij viti i është kushtuar Strehimoreve Publike dhe atyre kolektive, ku është përgatitur dokumentacioni për procedurë të hapët për dhënien në shfrytëzim me qira për gjashtë strehimore. Janë përpunuar 76 lëndë, prej tyre 18 aktvendime dhe 58 njoftime, përgjigje dhe vërtetime për palë.

Inspektorët për Mbrojtje dhe Shpëtim kanë kryer inspektime të vazhdueshme bizneseve në përputhje me Ligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore fatkeqësitë tjera dhe Ligjit për mbrojtje nga zjarri. Gjatë dhe pas vërshimeve inspektorët kanë vizituar mbi 100 shtëpi në lagjet Vreshtat, Kodra e Trimave, Kalabria, Arbëria, te Bunari i Hajratit, ura në Lagjen Kalabria, te lagja e Spitalit , fshatrat Shkabaj,Koliq Keqekollë etj ku është bërë vlerësimi i dëmeve dhe propozimet për tejkalimin e situatave. Sipas vlerësimit të komisionit të Komunës këto shtëpi sipas dëmeve të shkaktuara janë klasifikuar në tri kategori si vijon : Në kategorinë e parë janë 23 shtëpi, në të dytën 20 shtëpi dhe në të tretën 18 shtëpi.

Operatorët e Qendrës për Informim, Alarmim dhe Koordinim (QIAK) kanë kujdestaruar 24 orë. Kjo Qendër rregullisht dhe me kohë ka përgatit raportet dhe informatat ditore, javore, mujore dhe vjetore dhe me kohë ka informu organet përgjegjëse komunale. Gjatë këtij viti është vendosë Laura në hyrjen kryesore në Ndërtesën e Komunës, është realizuar Projekti për Sinjalizimin e Alarmimit Publik dhe janë vendosur katër pika në qytet për alarmim publik. QIAK rregullisht bënë kontrollimin e radio – lidhjeve bazë në Bashkësitë Lokale – Urbane dhe Rurale, bënë programimin e tyre verifikon dëgjueshmërinë, dhe organizon trajnime të rregullta me operatorët e vetë.

Bashkëpunëtorët për Aftësim, Evidentim dhe Plotësim kanë vizituar të gjitha Bashkësi Lokale të qytetit dhe rurale. Qëllimi i këtyre vizitave ka qenë verifikimi i plotësimit të Kartelës Familjare që mbahet në Bashkësi Lokale me shënime shumë të rëndësishme në njerëz dhe në të mira materiale. Kanë bërë verifikimin veç e veç të çdo Bashkësie Lokale ku janë të formuara Shtabet dhe Ekipet për Mbrojtje dhe Shpëtim në raste emergjente. Janë angazhuar në vizitat shumë herë të Strehimoreve Publike dhe atyre banesore me ç’ rast kanë përgatit Raport të zgjeruar I cili ka shërbyer që të merren masa sa ma parë për sanimin e tyre që ato të kthehen në gjendje normale dhe që të mund të përdoren për destinimin që kanë strehimoret publike.

Inspektorët e parandalimit dhe hulumtimit nga zjarri gjatë këtij viti kanë hulumtuar 88 raste të zjarreve,kanë nxjerrë 172 masa me afat , kanë dhënë 437 masa të tjera,kanë nxjerrë 35 aktvendime dhe kanë përgatitur 89 proces – verbale.

Brigada e Zjarrfikësve të Prishtinës (BZP) është treguar profesionale në menaxhimin e situatës me rastin e shpërthimit të bombolës dhe rasteve të fikjes së zjarreve në banesat kolektive në qytet dhe në shpëtim e jetës së njerëzve. Brigada është pajisur me tri automjete që kanë ndikuar në efikasitetin në punë. Angazhimi i BZP-së gjatë vitit 2008 ishte mjaftë i madh: 754 dalje në terren, 546 intervenime në zjarre, 14 aksione në rrugë etj.

d. Koordinimi i punëve me ndërmarrjet publike komunale

Në vitin 2008 është realizuar një bashkëpunim i koordinuar me ndërmarrjet komunale Pastrimi, Trafiku Urban,Hortikultura, Termokosi, Ndërmarrja Publike e Banesave (si dhe me ndërmarrjet e kontraktuara) për mirëmbajtje në qytet. Hyrja në fuqi e Ligjit për Ndërmarrjet

Publike ka ndihmuar në këtë koordinim të mirë. Gjatë muajit Prill 2008, me kërkesën e Komunës, Zyra për Rregullimin e Ujit dhe Mbeturinave (ZRRUM) ka lejuar futjen e operatorëve privat të licencuar që ka ndikuar ngritjen e kualitetit të shërbimeve.

Megjithatë, problem akoma është monopoli në grumbullimin e mbeturinave sepse ndërmarrja 'Pastrimi' është kompani e vetme e licencuar për grumbullimin e mbeturinave të amvisërisë dhe inkasimit të taksës nga qytetarët dhe bizneset. Komuna po punon ngushtë me këtë kompani (sidomos pas fuqizimit të ligjit për ndërmarrjet publike) me qëllim të përmirësimit të pastërtisë në qytet. Gjatë vitit 2008, kjo ndërmarrje ka blerë 400 kontejnerë të rinj dhe 10 kamioneta të cilat do të zëvendësojnë traktorët me të cilët grumbullohen mbeturinat në disa lagje të Prishtinës. Shkalla e inkasimit në këtë vit ka qenë rreth 45% e vlerës së faturuar. Megjithatë, komuna nuk është e kënaqur me nivelin e punës që po kryen kjo kompani.

Bashkëpunim jashtëzakonisht i mirë është realizuar edhe me ndërmarrjen publike komunale "Hortikultura". Me këtë kompani janë realizuar projekte atraktive në ngritjen e dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra. Punëtorët e Hortikulturës kanë qenë në përkrahje të plotë për aksionet e udhëhequra nga inspektoratit komunal dhe ai i ndërtimit. Në kuadër të kompetencave ligjore, DSHPEC së bashku me ndërmarrjen publike komunale "Trafiku Urban", Ndërmarrjen Publike të Banesave dhe "Termokos" ka zbatuar rregulloret e komunës në fushat përkatëse të përgjegjësisë së këtyre ndërmarrjeve. Në sezonin e nxehjes "Termokos" ka ofruar shërbime më të mira se vitet e kaluara dhe ka arritur që me punë të mirë menaxheriale të ngritë nivelin e inkasimit.

e. Angazhimet shtesë të DSHP dhe EC

Drejtoria ka dhënë kontribut në Funksonimin e Kolegjiumit të shërbimeve publike në Asociacionin e komunave të Kosovës (AKK). Ky kolegjium udhëhiqet nga Drejtori i DSHPEC. Jemi përfaqësues të AKK për projektet e Shërbimeve publike në NALAS (NALAS - Rrjeti i asociacioneve të autoriteteve lokale në Evropën Juglindore) dhe udhëheqës të Komisionit për transport në kuadër të Kolegjiumit të Shërbimeve publike të AKK. Është dhënë kontribut përmbajtjesor në formulimin e Deklaratës parimore për shërbime publike të Kolegjiumit të SHP-të. Është arritur bashkëpunim me Organizatën qeveritare gjermane GTZ për mbështetje të komunave në fushën e shërbimeve publike. Ky bashkëpunim i mirë ka rezultuar me përkrahje të komunës tonë në realizimin e një pilot projekti për klasifikimin dhe ndarjen e mbeturinave të grumbulluara në Lagjet Velania dhe Dardania. Është arritur bashkëpunim me Bankën Botërore, e cila për rregullimin e transportit të udhëtarëve ka angazhuar kompaninë për konsulencë ROM Ltd. Në bazë të këtij raporti janë paraparë edhe investimet kapitale në modernizimin dhe shtimin e pikave të semaforëve dhe ndërtimi i qarkut rrethor të QKUK dhe në rrugën "Ilir Konushevi", organizimi i transportit në bazë të transportit integral, biletat integrale, projektet koncesionale për shtimin e hapësirave për parkim etj.

f. Rrethanat kufizuese

Detyrat voluminoze që shtrohen para kësaj drejtorie, qesin në pah disa kufizime që vështirësojnë realizimin e plotë të rolit të saj. Drejtoria ka mungesë të kuadrove profesionale në fusha të caktuara dhe në BZP. Shumë projekte të përbashkëta me partnerët ndërkombëtar janë të kushtëzuar me angazhimin e eksperteve në sektorët profesional të drejtorisë. Ligji për Mbeturina obligon që në kuadër të sektorit të shërbimeve publike të jetë një shërbim të

veçantë për licencim të operatorëve ekonomik për grumbullimin e mbeturinave. Ky shërbim do të merrej edhe me hartimin e Strategjisë komunale për mbeturina e cila në bazë të Ligjit duhet të jetë e harmonizuar me Strategjinë shtetërore për menaxhimin e mbeturinave. Në mungesë të buxhetit të mjaftueshëm ende nuk është modernizuar brigada e zjarrfikësve me mjete teknike. Po ashtu, buxheti për mirëmbajtje verore dhe dimërore të 180 rrugëve të kryeqytetit nuk mjafton që të kemi mirëmbajtje të mirë kur dihet se kemi rreth 500 rrugë në kryeqytet. Makinaria të cilën sot e posedon NPK Pastrimi nuk është garanci për mirëmbajtje dimërore të rrugëve. Për këtë qëllim duhet të rishikohet mënyra e lidhjes afatshkurtër të kontratave dhe të inkurajohen kompanitë që me kontrata më afatgjate të investojnë në modernizimin e makinave të specializuara për pastrimin e borës.

5. DREJTORIA E ARSIMIT DHE KULTURËS

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës ka bërë përpjekje për realizimin punëve dhe detyrave të planifikuara sipas dinamikës në të tri fushat e veta. Objektivat kryesore të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës për viti 2008 kanë qenë:

1. Angazhimi për realizimin e projekteve të ndryshme nga fusha e investimeve kapitale për ndërtimin dhe renovimin e shkollave ,objekteve të kulturës, sportit dhe objekteve tjera përcjellëse.
2. Sigurimi dhe plotësimi i kuadrit mësimor dhe udhëheqës për këtë periudhë bazuar në nevojat dhe kërkesat e drejtorive të institucioneve arsimore dhe mbështetja për aftësimin e kuadrit udhëheqës dhe arsimor nëpërmjet të trajnimeve të ndryshme të organizuara nga MASHT-i, Drejtoria dhe OJQ-ët.
3. Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie,
4. Organizimi dhe realizimi i aktiviteteve të ndryshme kulturore-sportive në shkollat e të gjitha niveleve .
5. Angazhimi i drejtorisë për mirëmbajtjen e objekteve shkollore, të kulturës dhe të sportit për të krijuar kushte optimale për mirëvajtjen e procesit mësimoro-edukativ dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturo-sportive.
6. Subvencionimi i projekteve nga sfera e kulturës,gjinisë,sportit dhe rinisë.

Rrjeti e arsimit parauniversitar në Komunën e Prishtinës, gjatë vitit 2008 ka qenë e organizuar në 86 institucione (publike dhe private, parashkollore dhe shkollore, në të tri nivelet) në të cilat kanë vijuar mësimin 53,094 fëmijë dhe nxënës të organizuar në 1,896 paralele deri në fund të semestrit të dytë të të njëjtit vit shkollor.Në statistikën e vitit të ri shkollor 2008/2009 shihet se ky numër i nxënësve u rritë në 55.050 sish të sistemuar në 1946 paralele dhe grupmosha.Pra, shihet se në këtë vit shkollor, mësimin e vijoje në rreth 1956 fëmijë dhe nxënës dhe fëmijë më shumë se një vit më parë.

a. Statistikat e arsimit

Në nivelin parashkollor, në fillim të vitit të ri shkollor 2007/2008, kanë qenë të përfshirë 2051 fëmijë të sistemuar në nëntë institucione parashkollore, respektivisht në 151 grupmosha. Në arsimin parafillor 1640 nxënës me 40 paralele, në arsimin e obliguar publik mësimin e kanë vijuar 34.071 nxënës të sistemuar në 43 shkolla fillore amë dhe në 23 paralele të ndara fizike, respektivisht në 1324 paralele. Qendra burimore ‘PERPARIMI’ ka funksionuar në objektin e shkollës ‘Naim Frasheri’ me 97 nxënës me nevoja të veçanta. Po ashtu pjesë e kësaj skeme ka qenë edhe Kuzhina e IP-ve. Në arsimin e mesëm të lartë mësimin e kanë vijuar 13.933 nxënës, të sistemuar në 369 paralele dhe 12 objekte shkollore (nxënësit serb mësojnë në objektet e shkollave fillore).

Gjatë vitit 2008, 180 fëmijë janë edukuar në shtatë institucione parashkollore private prej të cilave vetëm dy kanë qenë të licencuara, 967 nxënës të nivelit fillor dhe 1001 nxënës të nivelit të mesëm shkollor e kanë vijur mësimin në 11 objekte(institucione) shkollore private të sistemuar në 64 paralele. Në Komunën e Prishtinës edukimi dhe arsimimi i fëmijëve dhe nxënësve është zhvilluar në gjuhët amtare për të gjitha nacionalitetet. . Në të gjitha institucione publike kanë punuar 3.342 mësime dhe punëtorë të shërbimit tekniko-administrativ dhe udhëheqës.

Në Komunën e Prishtinës hapësira e mësimin është 0.86 m² për nxënës, ndërsa sipas standardeve duhet të jetë 1.80- 2.20 m² për nxënës. Nga pjesëmarrja në numër dhe hapësirë e shkollave në nivel vendi, Komuna e Prishtinës përfaqësohet më 7.25% ndërsa pjesëmarrja e nxënësve nga Komuna e Prishtinës në nivel vendi është 15,73%.

b. Ngritja e infrastrukturës shkollore, kulturo-sportive dhe furnizimet

Për investime në arsim në vitin 2008 nga janë destinuar gjithsej 7.038.953 €, prej të cilave nga buxheti i Komunës 1.660.000 €, dhe 5.398.953 € nga MASHT.

Shkollat të cilat janë përfunduar në vitin 2008 dhe ato që kanë filluar në vitin 2008

	SHKOLLAT	Investitori		Fillimi	Përfundimi
1	Shkolla Fillore Mat	MASHT		2007	2008
2	Shkolla Fillore në Dabishevc		Komuna	2008	2008
3	Shkolla Fillore në Glllogovicë		Komuna	2008	2008
4	Shkolla fillore në Vranidoll-aneks		Komuna	2008	2008
5	Shkolla Fillore në Halitaj-Mramuer		Komuna	2008	2008
6	Shkolla Fillore në Llukar	MASHT		2007	2008
7	Shkolla Fillore në Lagjen e Spitalit		Komuna	2007	2009
8	Shkolla Fillore në Vreshta		Komuna	2007	2009
9	Shkolla Fillore Podaj-Koliq		Komuna	2008	2009
10	Shkolla Fillore në Bardhosh	MASHT		2008	2009
11	Gjimnazi Xhevdet Doda	MASHT	Komuna	2008	2009
12	Shkolla e Mesme ne Qameri	MASHT		2008	2009
13	Shkolla e Mesme (TI)	MASHT		2008	2009

Objektet shkollore të planifikuara në Kalabri, Arbëri dhe Sofali nuk kanë filluar të ndërtohen për shkak të procedurave të rregullimit të pronës, ndërsa objekti i shkollës së mesme të muzikës (investim nga MASHT) do të fillojë së shpejti (projekti është në procedure revidimi). Poashtu ka filluar ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHMM ‘Ali Sokoli’ dhe janë bërë përgatitjet për fillimin e ndërtimit të sallës së ed. fizike në shkollën fillore ‘Xhemal Mustafa’, ndërsa sallat e shkollave fillore ‘Nazim Gafurri’, ‘Faik Konica’ dhe ‘Hilmi Rakovica’, për shkak të konkurrencës së papërgjegjshme dhe jo të mjaftueshme janë anuluar tenderet dhe janë bartur për vitin 2009.

Është lidhur Marrveshja e Mirëkuptimit me USAID-in dhe CHF-ën për ndërtimin e katër anekseve shkollore dhe një objekti të ri shkollor”Shkolla e Gjellbërt”.Për këto projekte donatorët do të investojnë rreth 560.000€.Pjesën tjetër do ta investojë komuna. Po ashtu, në bashkëpunim me KFOR-in finlandez dhe Karabinierët italian ,është financuar renovimi i objektit të shkollës fillore”Ditët e Minatorit” PNF në Shashkoc(40.000€). Nga Banka Botrore i kemi përfituar 15 projekte në vlerë rreth 60.000€, për furnizim të 15 shkollave me mjete mësimore,ndërsa në fushën e kulturës përkatësisht për fushën e trashëgimisë

kulturore, nga SIDA suedeze kemi fituar një donacion prej 40.000€ për hartimin e projektit restaurues dhe gërmimet arkeologjike në Hamamin e Madh të Prishtinës.

Kanë përfunduar rreth 90% e punimeve në terrenet sportive në Dardani dhe Barilevë, kurse kanë filluar punimet në ndërtimin e terrenit sportiv në oborrin e shkollës fillore "Emin Duraku" dhe në oborrin e shkollës fillore "Zenel Hajdini". Projektet e terreneve sportive në Arbëri dhe në Kodrën e Diellit janë bartur për vitin 2009 (për shkak të mungesës së mjeteve). Tereni sportiv në Llukarë nuk është realizuar për shkak të kontestit pronësor.

Në fushën e kulturës ka përfunduar restaurimi i fazës së parë të Hamamit të Qytetit, ka përfunduar ndërtimi i pjesës së parë të Qendrës Kulturore të Fëmijëve në Gërm (në vlerë prej 250,000 €), kanë vazhduar punimet në Arkivin e Qytetit (donacion i Agjencionit Evropian), më në fund u caktua lokacioni për ndërtimin e bibliotekës "Hivzi Sylejmani" në lagjen Dardania në sipërfaqe prej 30 ari dhe është shpallë tenderi për hartimin e projektit ideor dhe zbatues.

Janë realizuar tenderët për renovimin dhe lysterjen e 40 institucioneve shkollore të të gjitha niveleve (në vlerë prej 304,572 €), janë proceduar dhe realizuar tenderët për furnizim me material didaktik, rekuizita sportive, material administrativo-pedagogjik, material ushqimor për IP-ët, material sanitar për të gjitha nivelet, me inventar shkollor dhe janë ofruar shërbimet e servisimit për pajisjet teknike shkollore. Poashtu të gjitha institucionet janë furnizuar me lëndë djegëse (naftë, dru dhe thëngjill).

Janë furnizuar institucionet shkollore me materiale tjera të nevojshme sipas specifikave si: rekuizita didaktike, furnizime me material riparues, furnizimi me tekste shkollore, transportin e nxënësve dhe mësimit dhe janë bërë të gjitha përgatitjet për shpalljen e tenderëve për furnizime për vitin 2009.

Institucionet parashkollore të Prishtinës janë mbështetur nga shumë donatorë (KFOR, ProCredit Banka, Shoqata Miqtë e Amerikës etj.) rekuizita sportive, kompjuterë dhe pajisje tjera me mjete mësimore. Vlera e të gjitha këtyre ka qenë rreth 20,000 Euro.

Në mbështetje të SWISSCONTACT-it, janë realizuar 3 projekte në shkollat e mesme profesionale: shkolla 'Hoxhë Kadri Prishtina', shkolla 'Shtjefën Gjeqovi' dhe shkolla bujqësore 'Abdul Frashëri'. Vlera e këtyre projekteve ka qenë 49,000 € dhe ka shkuar në themelimin e firmave ushtrimore.

c. Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor

Gjatë këtij viti janë organizuar disa trajnime dhe punëtori për aftësimin e personelit arsimor në harmoni me reformat dhe procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Pra, janë organizuar trajnime të mësimitdhënësve të klasave të para dhe klasave të pesta. Gjithashtu është organizuar edhe trajnimi i mësimitdhënësve për punë me fëmijë që kanë pengesa në zhvillim në mënyrë që të bëhet integrimi i tyre në paralelet e rregullta. Përveç këtyre, janë organizuar edhe dy punëtori për trajtimin e delikuencës në shkolla dhe integrimin e fëmijëve me pengesa në zhvillim në bashkëpunim me Terre des Homes dhe Handikosin. Në institucionet edukativo-arsimor janë realizuar 285 vizita informative, 138 vizita speciale, 71 vizita të përgjithshme dhe 47 vizita kthyes, në të gjitha nivelet e arsimit.

Gjatë vitit 2008 janë organizuar edhe 5 mbledhje pune me Këshillin e Psikologëve dhe Mjekëve shkollor dhe 12 takime pune me drejtorë të të gjitha institucioneve arsimore të Komunës së Prishtinës.

d. Rezultatet e nxënësve në mësim

Në semestrin e dytë të vitit shkollor 2007/2008, sipas rezultateve të përpunuara në nivelin e parë (klasat I-V) të arsimit, kalueshmëria e nxënësve ishte 99,61% me notë mesatare 4.18. Në nivelin e dytë (klasat VI-IX), kalueshmëria ishte 92% me notë mesatare 3.8. Në nivelin e tretë, respektivisht në tri gjimnaze dhe Medresen "Alaudin" kalueshmëria ishte 72.8% me notë mesatare 3.7, ndërsa në shkollat profesionale të këtij niveli kalueshmëria ishte 64.3% me notë mesatare 3.4.

Duhet theksuar se në testin kombëtar të semimaturës, shkalla e arritshmërisë ishte 51.75%, ndërsa në testin kombëtar të maturës të nivelit të tretë të arsimit ishte 68.87%, e cila në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ka tendencë rritjeje për 1.5%. Janë regjistruar 1,680 fëmijë në institucionet parafillore të sistemuar në 42 paralele, 3.600 nxënës në klasën e parë, dhe në klasën e dhjetë janë regjistruar 4035 nxënës, të sistemuar në 107 paralele.

Në semestrin e parë të vitit shkollor 2008/2009, në shkollat fillore të komunës së Prishtinës (klasat I-V) kanë vijuar mësimin 18,286 nxënës, të sistemuar në 745 paralele. Suksesi i arritur: të shkëlqyeshëm 69.8%, shumë të mirë 16.4%, të mirë 9.16% dhe të mjaftueshëm 2.97% (gjithsej me sukses pozitiv 98.3%), nota mesatare 3.98. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraprak kalueshmëria ka shënuar rritje për 0.4%, ndërsa nota mesatare ka shënuar rënie për 0.46. Poashtu, në këtë semestër, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit tjetër numri i nxënësve ishte më i madh për 319.

Në semestrin e parë të vitit shkollor 2008/2009, në arsimin e mesëm të ulët (klasat VI-IX) mësimin e kanë vijuar 15,067 nxënës, të sistemuar në 558 paralele. Suksesi i arritur: të shkëlqyeshëm 30%, shumë të mirë 22%, të mirë 18% dhe të mjaftueshëm 3.6% (gjithsej me sukses pozitiv 73%). Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, kalueshmëria ishte më e lartë për 2%, ndërsa nota mesatare ka shënuar rritje për 0.35 (nga 3.20 në 3.55). Edhe në këtë nivel është rritur numri i nxënësve për 441 në krahasim me vitin paraprak.

Në semestrin e parë të vitit shkollor 2008/2009, në shkollat e mesme të komunës së Prishtinës kanë vijuar mësimet 13,788 nxënës, të sistemuar në 391 paralele. Suksesi duket kështu: me sukses të shkëlqyeshëm 11.4%, me sukses shumë të mirë 12.9%, me sukses të mirë 6.5% dhe me sukses të mjaftueshëm 2.12% (gjithsej me sukses pozitiv 33%). Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraprak shkalla e kalueshmërisë nuk ka ndryshuar, ndërsa nota mesatare ka shënuar ngritje për 0.69. Poashtu edhe në këtë nivel vërehet rritje e numrit të nxënësve për 895 sish.

e. Shërbimi i punëve të përgjithshme administrative

Gjatë vitit 2008, shërbimi i punëve të përgjithshme ka kryer të gjitha punët dhe detyrat në fushën e administratës. Drejtorisë i kanë arritur mbi 1,099 lëndë për shqyrtim, prej të cilave 534 janë miratuar, 145 janë refuzuar, 153 kanë pasë karakter njoftimi, ndërsa të tjerat kanë pasur përmbajtje të pyetje-përgjigjeve. Gjatë vitit janë shpallur, pos konkursit të rregullt, edhe 11 konkurse plotësuese për pranimin e kadrove në shkolla në të tri nivelet. Poashtu

janë zhvilluar procedurat për t'i lidhur kontratat për shfrytëzimin e tereneve sportive për klubin "Rilindja", "Bardhoshi" dhe për stadiumin e qytetit, ndërsa tereni sportiv në Ulpianë, në Dardani dhe në Gërmi i janë dhënë në mirëmbajtje "Hortikulturës".

f. Sektori i Kulturës dhe Gjinisë

Në fushën e kulturës janë realizuar aktivitetet sipas prioriteteve të bazuara në strategjinë e politikave komunale për këtë vit. Janë mbuluar të gjitha ngjarjet e mëdha kulturore të rangut komunal dhe shtetëror: Dita e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, Dita e Prishtinës, Dita e Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pritja dhe përcjellja e Kryetarit të Republikës së Shqipërisë Z. Bamir Topi në Prishtinë, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, Dita Ndërkombëtare e Muzikës, Festivali "Re Muzika", "Promenadë Vere", Talentët e Rinj të Muzikës Serioze (niveli shtetëror), subvencionimi i botimit të disa veprave letrare dhe veprave tjera, botimi i disa publikimeve të ndryshme, realizimi i disa ekspozitave nga artet pamore dhe trashëgimia kulturore. Janë organizuar Garat e Recitatorëve, për nderë të "7 Marsit", Garat e Diturisë, për nderë të "Ditës së Prishtinës". Po ashtu janë përkrahur të gjitha institucionet shkollore gjatë manifestimeve interne kulturore.

Subvencionimi i projekteve të kulturës

Janë përkrahur 238 projekte në vlerë prej 236,570 €, të cilat në krahasim me vitin 2007 kanë shënuar rritje për 58 projekte dhe 11,300 € më shumë. Të gjitha këto projekte janë subvencionuar sipas kësaj skeme:

- Datat e rëndësishme historike dhe kulturore (11 projekte, në vlerë 54.300 €)
- Festivelet brenda dhe jasht vendit (23 projekte, në vlerë 49.130 €)
- Koncerte të ndryshme (86 projekte, në vlerë 25.380 €)
- Projektet për artet pamore (9 sish, në vlerë 5200 €)
- Veprimtaria botuese (26 tituj, në vlerë 26.260 €)
- Veprimtaria teatrale (17 projekte, në vlerë 31.100 €)
- Veprimtaria filmime (4 projekte, në vlerë 7800 €)
- Qendra Kulturore e Fëmijëve (17 projekte, në vlerë 6000 €)
- Arkivi i Prishtinës (5 projekte, në vlerë 10.000 €)
- Grupet artistike (8 projekte, në vlerë 7000 €)
- 12 projekte për çështje gjinore dhe integrimet socio-kulturore, në vlerë 13.400 €
- Asambleja Komunale e Fëmijëve ka realizuar 10 projekte humanitare dhe i ka mbajtur 20 seanca ku janë trajtuar tema të ndryshme.

Me mbështetje dhe mbikëqyrje të DAK-ës, institucionet kulturore të komunës si Teatri "Dodona", Qendra Kulturore e Fëmijëve, Biblioteka "Hivzi Sylejmani", Arkivi i Qytetit dhe Instituti i Monumenteve kanë realizuar një mori projektesh nga fushëveprimi i tyre për nevojat e Komunës dhe institucioneve tjera të Republikës së Kosovës. Teatri "Dodona" ka realizuar pesë shfaqje teatrale, rreth 150 repriza të cilat i kanë përcjellë mbi 18,000 shikues. Qendra Kulturore e Fëmijëve ka realizuar mbi dhjetë koncerte dhe aktivitete tjera për fëmijë dhe të rritur, ka përfaqësuar Kosovën në Festivalin Ndërkombëtarë në Stamboll, në Durrës etj. Biblioteka "Hivzi Sylejmani" u ka ofruar shërbime të mjaftueshme të gjithë lexuesve të interesuar për librin. Instituti i Monumenteve në vazhdimësi ka bërë hulumtime dhe gërmime Arkeologjike në Prishtinë dhe rrethinë ndërsa Arkivi i Qytetit ka përmbushur kërkesat e parapara me ligj për ruajtjen e lëndës arkivore. Gjatë kësaj kohe Arkivi ka punuar në përpunimin e lëndës arkivore të Komunës dhe të disa shkollave tona.

rejtoria ka bashkëpunuar shumë mirë me të gjitha institucionet shtetërore, duke filluar nga Ministria e Arsimit, Ministria e Kulturës, Teatri Kombëtar, Filarmonia, Muzeu i Kosovës, Galeria e Arteve, Ansambli “Shota”, etj. Një bashkëpunim i mirë është zhvilluar me pjesën dërmuese të ambasadave, zyrave dhe përfaqësive të shteteve të ndryshme që punojnë dhe veprojnë në Republikën e Kosovës.

g. Sektori i Sportit dhe Rinisë

Në bazë të prioriteteve dhe planifikimit janë realizuar aktivitete të shumta sportive dhe rinore me rastin e shënimit të datave të rëndësishme historike, kulturore dhe sportive: Gjysmëmaratona Ndërkombëtare “Prishtina 2008”, Lojrat Olimpike të Kosovës për Përsona me Aftësi të Kufizuara (të dytat me radhë), Dita e Evropës më 9 Maj 2008, Dita e Prishtinës më 11 Qershor, Shpallja e Sportistit të Vitit (këto dy projekte janë përkrahur me rreth 13000 €), Garat Sportive Shkollore, organizimi i Turnirit të Basketbollit për Përsona me Aftësi të Kufizuara, Turniri Ndërkombëtar i Boksit dhe Turniri Tradicional i Shahut “Hyzri Talla”.

Nuk ka munguar bashkëpunimi me OJQ-ët e ndryshme me të cilat janë realizuar shumë aktivitete sportive dhe rinore: projektet me OJQ-ën Franceze “Sport Sans Frontieres” (Sporti pa kufi), OJQ-ën Qendra Rinore e Prishtinës, Rrjeti Rinor i Prishtinës, UNDP, Bankën Botërore etj. I tërë ky bashkëpunim ka pasur për qëllim rritjen e ndihmës për sportistët dhe rininë e Prishtinës. Një bashkëpunim i frytshëm është shënuar edhe me Departamentin e Rinisë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, që rezultoi me themelimin e grupit inicues të Këshillit të Veprimit Rinor. Janë organizuar edhe gara të ndryshme sportive, në nivel të shkollave të Komunës së Prishtinës, ku janë shpallur edhe sportistët më të mirë të vitit për kryeqytetin.

Subvencionimi i projekteve të sportit dhe rinisë

Në lëminë e sportit dhe rinisë janë subvencionuar 95 projekte në vlerë 119.764 € prej të cilave 69 ishin projekte që stimuluan aktivitetet e klubeve sportive dhe ngjarjet e rëndësishme sportive, 26 projekte u janë destinuar OJQ-ve për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme rinore dhe ngjarjeve rinore. Në krahasim me vitin 2007, gjatë vitit 2008 janë përkrahur 38 projekte në vlerë prej 50,329 € më shumë.

Ka shënuar rritje numri i kërkesave të klubeve të sporteve të ndryshme për t’u regjistruar në Sektorin e Sportit të Komunës së Prishtinës, të cilat janë zgjidhur pozitivisht dhe janë përkrahur materialisht. Jnë pranuar 55 kërkesa për përkrahje materiale të cilat Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës i ka vlerësuar pozitivisht dhe i ka realizuar.

6. DREJTORIA PËR INFRASTRUKTURË LOKALE

Drejtoria për infrastrukturës lokale ka kryer këto aktivitete: hartimi i detyrave projektuese dhe identifikimi i nevojave, shqyrtimi i kërkesave të banorëve të bashkësive lokale dhe inkorporimi i tyre në planet e komunës, njoftimi me kohë i kompanive publike dhe subjekteve relevante me qëllim të koordinimit të punëve, incizimi i gjendjes ekzistuese të infrastrukturës në qytetin e Prishtinës, hartimi i paramasave dhe parallogarive si dhe kompletimi i dokumentacionit teknik për procedimin e tyre në organet kompetente, mbikëqyrja e realizimit të projekteve konform marrëveshjes etj.

a. Projektet e realizuara të infrastrukturës rrugore

Gjatë vitit 2008 janë realizuar shumë projekte të infrastrukturës rrugore:

- gjatësia e përgjithshme të rrugëve të ndërtuara është **49,666 metra (ose 127% më shumë se në vitin 2007)**,
- gjatësia e rrugëve të shtruara me zhavorr është **14,400 metra**,
- me kubëza janë shtruar **138,950 m²**,
- me asfalt janë shtruar **127,200 m²**,
- janë ndërtuar kanalizime fekale në gjatësi prej **26,615 metra**,
- kanalizime atmosferike në gjatësi prej **10,130 metra**.

Po ashtu, gjatë vitit 2008 janë kryer edhe këto punë infrastrukturore të përcjella nga viti 2007:

- gjatësia e përgjithshme të rrugëve të ndërtuara është 21.842 m
- me asfalt janë shtruar 75,092 m²
- me kubëza janë shtruar 27,199 m²
- gjatësia e rrugëve të shtruara me zhavorr është 1,137 m
- janë ndërtuar kanalizime fekale në gjatësi 3,028 m
- kanalizime atmosferike në gjatësi prej 2,593 m

Nga viti 2007 janë bartur 20 rrugë që cilat kanë përfunduar gjatë vitit 2008. Vlera e punimeve në këto rrugë ka qenë 3,391,903 €. Këto projekte janë paraqitur në vijim.

Projektet e bartura nga viti 2007 të realizuara më 2008

Nr	Emri i projektit	Vlera
1	Ndërtimi i rrugës „Shpati"	42,667.52
2	Ndërtimi i rrugës „Nëna Terezë" prej Hotel Grandi deri te rruga „Eqrem Qabeji"	169,034.80
3	Rruga „Vllezërit Fazliu" (Pjesa e parë)	426,540.98
4	Rruga „Vllezërit Fazliu" (Pjesa e dytë)	605,826.67
5	„Mbretresha Teutë"	133,240.82
6	Rrugët te Tregu: Mehmet Kaqurri, Taip Krasniqi, Vasil Andoni, Ylfete Humolli,	154,986.09
7	„Tahir Meha “Jan Kukuzeli"	81,106.59
8	„Kukësi"	187,213.03
9	„Eduard Lirë"	183,052.15
10	„Bulevardi i Dëshmorëve"	365,462.25
11	„Mbreti Bardhyl Maliq Pashë Gjinolli"	171,881.62
12	„Janjevë Sushicë"	189,580.45
13	„Muharrem Fejza II"	113,947.84
14	„Ramë Govori"	78,167.53
15	„Rruga për Sofali"	50,606.00
16	„Isa Kastrati"	199,564.24
17	Ndërtimi i rrugës „Vllezërit Fazliu"-Elektrika	93,045.85
